

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
 Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
 Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7340 E mërkurë 1 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
 Nga KRESHNIK ÇIKA
Për Tahirin dhe jo vetëm...
 Këtu në Athinë, Athina zyrtare "fërkon barkun" me ato që ndodhin aty në Tiranë, me Tiranën zyrtare. E kanë kuptuar mirë që shteti i Tiranës ...
 Vijnë në faqen 20



Opinion **Ditës**
 Nga MIRON ÇAKO
Lojërat e fatit, një "fat" i keq!
 Lojërat e fatit si emërtim duket argëtues. Të argëtohet dikush është nevojë biologjike dhe shpirtërore e njeriut, ai relaksohet dhe qetësohet mëndërisht ...
 Vijnë në faqen 21



Presidenti: Kam armik vetëm krimin e organizuar

Presidenti: Do e shqyrtoj me qetësi Bendon, s'ka emergjencë

Përgjimet e SHISH me Nar Kokën? Për mua s'përbëjnë sekret. Ja çfarë kam folur me të...

Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dje, se shefin e ri të SHISH, pas largimit të Visho Ajazit ka ende kohë për ta dekretuar: I pyetur në një intervistë në "Fakt!", të gazetarit Çim Peka, Meta u shpreh se për çështjen "Tahiri" do të mbajë qëndrimin e tij në kohën e duhur, për sa kohë çështja është në hetim. ...
 Në faqen 2

EMRAT E TRASHËGIMTAREVE QË PERFITONJË DEMSHPERBLIMIN NGA QEVERIA

ISH-TE DENUARIT, LISTA E DYTE ME PERFITUESIT

Ministria e Financave publikon personat që do të marrin këstin e parë e të dytë. Lista me dokumentet që duhet të plotësojë gjithsecili për të marrë paratë



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 9-12

RAPORTI
Këshilla e OSBE: Përmirësoni bashkëpunimin e sistemin mes jush
 Në faqen 4

KREU I PD
Basha: Tahiri para drejtësisë. Rama e zëvendëson me Gjylmetin në PS
 Në faqen 5

DOSJA E PLOTE
Mashtrimi për vizat, prokuroria 18 vite burg për nënë e bijë
 Në faqen 6

PROJEKTI I RI
Banorët e Himarës me flamuj grek kundra shembjes, Athina mban qëndrim
 Në faqen 19

KRITERET

7 big lies of Germany

Gjermania: Ja kategoritë që mund të qëndrojnë në vendin tonë
 Në faqen 17

VIP Pages Modelja shqiptare me famë botërore pa të brendshme në "Halloween"

Rike Roci: Ja pse nuk kthehem në Shqipëri

Rrëfëhet bukurshja bionde: Pse nuk postoj foto me të dashurin

Nga PAMELA ALIAJ

Ajo njihet si një nga bukurshet, e cila u bë e famshme nëpërmjet shtëpisë më të madhe në Shqipëri, "Big Brother Albania". Prej kohësh bukurshja Rike Roci i është larguar vëmendjes së medias rozë duke mos dashur



të flasë shumë për jetën e saj private. Në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Rike flet për projektet e saj për të ardhmen dhe arsyen pse vendosi të largohet përfundimisht nga Shqipëria. Gjithashtu, ajo ka folur edhe për një projekt ...

Suplement

Në faqen 19

PRESIDENTI INTERVISTA

Tahiri e cilësoi "armik", Presidenti: Unë kam armik vetëm krimin e organizuar

Meta: Dorëheqja e Ajazit, e papritur "Bendon", do ta shqyrtoj me qetësi

"Përgjimet? Bisedat me Narin nuk janë ndonjë sekret"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dje, se shefin e ri të SHISH, pas largimit të Visho Ajazit ka ende kohë për ta dekretuar. I pyetur në një intervistë në "Fakt", të gazetarit Çim Peka, Meta u shpreh se për çështjen "Tahiri" do të mbajë qëndrimin e tij në kohën e duhur, për sa kohë çështja është në hetim.

Shefi i SHISH, Visho Ajazi Lika ka dhënë dorëheqjen. A ka dekretuar Presidenti Meta dorëheqjen e tij?

Për të shuar kuriozitetin tuaj, para se të nisësh për në studion tuaj, kam firmosur dekretin për lirimin nga detyra të Drejtorit të SHISH-it, z. Visho Ajazi pas dorëheqjes së tij.

Po dekretin e emërimit në detyrë të njeriut të propozuar nga kryeministri Rama, a e keni firmosur?

Nuk ka asnjë emergjencë për arsye të faktit që zvdrejtori i SHISH-it vazhdon detyrën.

Kur jeni njohur realisht me dorëheqjen e shefit të Shërbimit Informativ dhe a ka pasur ai garancinë tuaj se, në rast se kryeministri Rama i bën presion për të dhënë dorëheqjen, ju do ta mbrojt?

Së pari, unë në natyrën time gjithmonë në krye të institucioneve kam respektuar parimin e vazhdimësisë dhe në rastin konkret, aq më tepër që bëhet fjalë për një institucion të një rëndësie të veçantë dhe për sigurinë kombëtare, kam qenë i bindur që vazhdimësia gjithmonë është pozitive, është e rëndësishme në këto lloj institucioneve. Për pyetjen tuaj më konkrete, mund t'ju them që vetëm një javë më parë e kam siguruar z. Ajazi që ai do të kishte përkrahjen time të plotë si President i Republikës për të vazhduar detyrën e tij, gjithmonë duke u përqendruar në përkushtimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe natyrisht në përmbushje të detyrave të tjera që ka Shërbimi Informativ. Dhe ai më ka falënderuar për besimin. Kjo ka qenë thjesht për të konfirmuar një vazhdimësi, duke pasur në konsideratë edhe komentet e ndryshme mediatiqe që janë të zakonshme.

Mediat kanë aluduar se edhe në kohën kur z. Ajazi drejtonte SHISH-in ju jeni përgjatur z. Meta. Nuk i keni besuar aludimeve të mediaeve apo pavarësisht kësaj ju ishit i gatshëm ta mbronit z. Ajazi?

Së pari, unë nuk nisem në përmbushjen e detyrave të mia, aq më tepër të kësaj detyre kaq të lartë kushtetuese nga histori mediatiqe, nga të vërteta, nga të pavërteta dhe nga raporte personale të së kaluarës. Unë që nga 24 korriku i këtij viti shoh vetëm përpara, të paktën për pesë vitet e ardhshme dhe, në këtë drejtim, për mua interes ka

pasur dhe ka që ky institucion të përmbushë sa më mirë detyrën e tij, që padyshim mund ta kishte përmbushur edhe shumë më mirë se deri tani, aq më tepër kur vendi është vendosur në një pozicion jo të favorshëm për çështjen e trafikëve dhe sidomos të trafikut të kanabisit apo të drogës. Nuk mendoj se lufta kundër këtij fenomeni është një luftë që nuk ka pasur një angazhim dhe një përkushtim të SHISH-it, patjetër. Por, të gjithë ata që mendojnë, meqenëse ju iu referuat burimeve mediatiqe, që ka qenë ky angazhim që mund të ketë sjellë këtë situatë, është gabim. Sepse të gjithë e dimë që këto probleme janë bërë të ditura në mediat më të njohura ndërkombëtare në BBC, në ARD, në televizionet e njohura franceze. Nuk po flasim për ato italiane dhe padyshim që është një problem që mendoj se ekzagjerohet në këtë rast.

Pra, nuk ju ka shqetësuar ideja se mund të jeni përgjatur nga z. Ajazi?

Mua më jep kënaqësi çdo lloj ideje e këtyre përgjimeve, aq më tepër kur bëhet fjalë për rastin konkret, në rast se ju do t'ju konsideroni bisedat me Narin si përgjime shqetësuese.

A ju la të kuptonte z. Ajazi se do të jepte dorëheqjen?

Jo, asnjëherë nuk më ka lënë këtë përshtypje.

Dorëheqja e tij ka qenë një surprizë për ju?

Dorëheqja e tij ka qenë e papritur për shkak të bisedës së zhvilluar një javë më parë. Nuk ka rëndësi, por nuk më çudit shumë. Janë gjëra që ndodhin. Unë e respektoj vullnetin e cilitdo.

Sipas informacionit që kemi, arsyeja që kryeministri Rama i ka bërë presion shefit të SHISH-it për të dhënë dorëheqjen është se, me ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale, informacionet e SHISH-it mund të administrohen si provë në gjykatë. Nuk ka qenë më parë kjo praktikë. Kjo është arsyeja sipas meje që z. Rama i ka kërkuar me çdo kusht largimin...

Unë nuk mund të konfirmoj, sepse dorëheqja e z. Ajazi është paraqitur si rezultat i vullnetit të tij. Nëse ju doni të nënkuptoni që ekziston një vullnet për të manipuluar SHISH-in, që ai, gjithashtu, të manipulohet prova apo të dhëna, të cilat keqpërdoren, men-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

doj që kjo është shumë e gabuar.

Kryeministri Rama ju ka lënë një emër në tryezë, ka propozuar zvdrejtorin e dërranishëm të SHISH-it për të zënë vendin e Visho Ajazit. A është investuar Presidenti i Republikës për të investiguar mbi të shkuarën dhe CV-në e atij personi që do të jetë drejtues i Shërbimit Informativ?

Për të shuar kuriozitetin tuaj, nuk kam pasur mundësi as të lexoj këtë CV, që ju si gazetar pretendoni dhe nuk ka as ndonjë urgjencë për këtë çështje. Fakti që zotëria mban postin e zvdrejtorit tregon që është gjykurat i përshtatshëm nga autoritetet që e kanë propozuar dhe e kanë emëruar në këtë detyrë. Dhe njëkohësisht fakti që ky shërbim ka zvdrejtor është fakt pozitiv, sepse tregon që mund të vazhdojë të funksionojë. Sa i takon çështjes së dekretimit, sigurisht që, nëse nuk mund të mbash dikë përtej vullnetit të tij asnjë minutë më shumë në një detyrë nuk ka asnjë arsye për t'u nxituar për të nënshkruar një dekret, mendoj, të rëndësishëm.

A ju paraqiti z. Rama një argumentim të propozimit të tij apo thjesht ua emëroi në tavolinë z. Meta?

Mendoj që ka bërë një propozim të arsyeshëm sipas detyrës dhe pozicionit të tij.

Po sipas Presidentit Meta?

Sigurisht që është tepër herët.

Çfarë e pengon Ilir Metën, President, të thërrasë një mbledhje të KSK-së dhe të informohet për dosjen Habllaj.

mjaft i lartë.

A keni koment për rastin Tahiri duke qenë se edhe ju ka akuzuar direkt si një armik të tij?

Së pari, unë nuk dëshiroj të hyj në debate absurde dhe qesharake. Së dyti, në këtë pozicion që kam unë, kam vetëm një kundërshtar që është krimi i organizuar dhe kam një qëllim, që t'i shërbejë forcimit të sigurisë kombëtare të Shqipërisë. Në këtë drejtim mbështes punën e institucioneve të drejtësisë për të luftuar me profesionalizëm dhe me kurajë krimin e organizuar. Trafiqet dhe çdo rast të veçantë për të ecur drejt të vërtetave në mënyrë profesionale, ligjore dhe me vendosmëri, pavarësisht nga presionet apo tensionet politike, të cilat kur bëhet fjalë për përfshirje të politikanëve janë normale, janë të natyrshme.

Nuk hyj në raste dhe emra konkretë, sepse jo vetëm që është pozicioni i tillë, por ky është një hetim, një proces. Prokuroria ka paraqitur provat e saj me të cilat unë nuk jam i njohur dhe nuk jam në gjendje të bëj vlerësimin e duhur. Anëtarët e komisionit parlamentar nga të dy palët kanë qenë të pranishëm në instancat publike, dhe jo publike, kanë dhënë mendimet e tyre.

Duke qenë se kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, a e keni thirrur në takim Prokurorin e Përgjithshëm. A është i informuar Presidenti se çfarë po ndodh?

Jo. Prokurori i Përgjithshëm nuk më ka informuar dhe as nuk kam dashur të informohem për çështjen konkrete, pra për çështjen Habllaj dhe për gjithçka që mund të përfshihet në këtë hetim.

Pse s'keni dashur të informoheni, z. President?

E para, kjo është një çështje me të cilën po merret prokuroria.

A ndiheni pak i kompleksuar nga akuzat që ju ka bërë ish-ministri i akuzuar për trafik droge?

Unë nuk kam asnjë kompleks nga asnjë lloj akuzë. Lëkura ime është mësuar dhe i ka përballuar të gjitha akuzat dhe sot është këtu ku është dhe për shkak të këtyre eksperiencave nuk mundet të bëjë veprime, të cilat mund të mos i ndihmojnë këto procese. Në rast se një prokuror do të kishte shprehur një



Gjatë një mbledhjeje Grupi të Partisë Socialiste

shqetësim se ai po intimidohet për shkak të detyrës së tij për një çështje që ka të bëjë me një kryebandit apo me një politikan, kushdo qoftë ky dhe për këtë arsye kërkoi mbështetjen e Presidentit të Republikës, pa asnjë diskutim që Presidenti i Republikës do të jepte mbështetjen më të fortë dhe më të madhe.

A mendoni se mund ta besojë publiku që deklaratat e kryetarës së LSI-së, znj. Kryemadhi, bashkëshortes suaj, janë tërësisht të pandikuar prej Presidentit Meta, pavarësisht se ajo ju ka akuzuar dhe ju?

Përsëri nuk dëshiroj të përfshihem në debate apo polemika të tilla. Megjithatë mund të jap një sqarim për rastin konkret. Unë në shtëpi nuk jam President, jam bashkëshort, jam prind, ashtu sikurse në lagje meqenëse prej më shumë se një viti jemi bashkë në një lagje, nuk jam President dhe nuk sillem si i tillë, por si një banor i zakonshëm i lagjes.

Dua t'ju siguroj se që nga 24 korriku raportet e mia janë krejtësisht të qarta edhe me partinë që kam drejtuar edhe me skenën politike në vend. Unë jam përkushtuar një detyrë, një institucion.

A ndiheni përgjegjës që e mbart z. Rama kryeministër për katër vite?

Unë mendoj se cilido ka përgjegjësi të tij. Dhe natyrisht që unë kam përgjegjësi të mia, por nuk është koha këtu për të bërë analiza për të kaluarën, sepse thashë që e kam një ndarje për të kaluarën, edhe për arsye etike, edhe për arsye të institucionit që përfaqësoj. Është koha që të gjithë të punojmë për të pasturuar njëherë e mirë Shqipërinë nga ky fenomen dhe nga çdo derivat tjetër dhe nga krimi i organizuar, sepse është një krim i organizuar jo thjesht shqiptar. Është një krim i organizuar transnacional, ndërkombëtar dhe për një vend me kapacitete modestë si Shqipëria është mjaft shqetësues, pasi mund të jetë shumë ndikues për të ardhmen e vendit në drejtimin e gabuar.



Pas pezullimit, kryesia e PS analizon situatën e ish-ministrit

Tahiri në hetim, Gjylameti e Spiropali e zëvendësojnë në PS

Të deleguarit raportojnë për procesin zgjedhor

Darina Tanushi

Blerina Gjylameti do të zëvendësojë Saimir Tahirin në postin e kryetarit të PS-së për Tiranën, ndërsa Elisa Spiropali do ta zëvendësojë në postin e koordinatorit kombëtar të bashkëqeverisjes. Kjo u vendos mbrëmë në mbledhjen e kryesisë së PS-së, pas pezullimit të Tahirit pak ditë më parë, ndërsa është duke u hetuar për lidhje me bandën e Habilajve, sipas akuzave të prokurorisë. Sekretari i Përgjithshëm i PS-së, njëherësh edhe kryetar i grupit parlamentar, Taulant Balla u shpreh dje pas mbledhjes: "Kryesia e Partisë Socialiste ka mandatuar Elisa Spiropalin që të jetë koordinatoreja Kombëtare e Bashkëqeverisjes me Njerëzit, për të vijuar punën intensive që sapo e kemi nisur: të komunikimit në çdo cep të Shqipërisë, me këdo që është i gatshëm të bëhet pjesë e kësaj aliance të madhe të bashkëqeverisjes për Shqipërinë që duam". Elisa Spiropali është anëtare e Partisë Socialiste që nga viti 2009, anëtare e Asamblesë Kombëtare, ndërsa ka qenë kryetare FRESH, këshilltare në Bashkinë Tiranë, sekretare për rininë në kryesinë e Partisë Socialiste, ndërsa në 25 qershor u zgjodh deputete në qarkun e Korçës. "Po ashtu dua të komunikoj me ju që kryesia e partisë shprehu qoftë vlerësimin për punën e deritanishme, por edhe besimin e madh që kolegja jonë Blerina Gjylameti të drejtojë Partinë Socialiste të Tiranës prej këtej e në vijim", njoftoi Balla. Në vitin 2013 Gjylameti është zgjedhur deputete e Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë në legjislaturën e VIII si dhe anëtare e Komisionit parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Blerina Gjylameti ka hyrë në politikë në vitin 2012, ku është zgjedhur kryetare e Forumit të Gruas Socialiste në Tiranë. Gjylameti vjen nga radhët akademike dhe me një formim ekonomik. Tahiri u pezullua nga funksionet e tij në PS deri në përfundim të hetimit të çështjes, me të drejtën e rikthimit "me ndërmin" që i takon në PS, siç deklaroi Edi Rama, javën që shkoi. Po dje, sipas Ballës, kryesia e PS-së dëgjoi edhe raportimet e të deleguarve për analizën e ecurisë së deritanishme të procesit të



Kryetar i grupit parlamentar, Taulant Balla

zgjedhjeve në Partinë Socialiste. "Siç e dini, prej datës 15 shtator nuk kemi filluar një proces zgjedhesh në nivelin e parë dhe të dytë të organizimit në Partinë Socialiste, atë të kryetarëve të organizatave. Dhe më pas do të pasojë me zgjedhjen e kryetarëve të Këshillave Socialiste në çdo njësi administra-

tive, në 384 njësitë administrative të Shqipërisë", njoftoi Balla. "Si sekretar i përgjithshëm shpreh kënaqësinë për ecurinë e deritanishme. Nesër, ne do të kemi edhe kryetarët në nivel bashkie të Partisë Socialiste për një raportim dhe identifikim më të detajuar të problematikës që kemi hasur,

përmes ecurisë së deritanishme të procesit. Po ashtu, ka pasur një raportim edhe për ecurinë e deritanishme të një prej veprimeve më të rëndësishme politike tonat qoftë si Partit Socialiste, qoftë si grup parlamentar, por qoftë edhe si qeveri: atë të bashkëqeverisjes me njerëzit", tha Balla.

BLERINA GJYLAMETI

"Përtej kënaqësisë dhe vlerësimit ndiej përgjegjësinë e jashtëzakonshme që mu ngarkua sot nga kryesia e Partisë Socialiste dhe kryetari z. Edi Rama për drejtimin e degës së PS-së Tiranë. Detyra kërkon dyfish energji së pari, për të ndjekur hapin e shpejtë të socialistëve të palodhur e të përkushtuar të Tiranës, e duke vijuar më pas me detyrimin moral për t'u përgjigjur bashkëqeverisjes me njerëzit. Falënderoj paraardhësin e kësaj detyre, Saimir Tahirin për vullnetin e spikatur dhe frymën e palodhur të bashkëpunimit në këtë detyrë, të cilin i uroj sa më shpejt fitoren në luftën e tij për të vërtetën."

ZGJEDHJET

Prej 15 shtatorit, PS është në një proces zgjedhor. Sot pritet të raportojnë kryetarët në nivel bashkie për të identifikuar me detaje problematikat që janë hasur në këtë proces zgjedhor. Po ashtu, në kryesinë e djeshme është raportuar edhe për ecurinë e bashkëqeverisjes me qytetarët.



Rruga e Arbrit

Ndërtimi i Rrugës së Arbrit, shpallet kompania fituese

Komisioni i dhënies me koncesion të procedurës me objekt "Përmirësimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit" përfundoi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura në sistemin elektronik të APP duke shpallur fituese shoqërinë "Gjoka Konstruksion". Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin elektronik, në këtë procedurë rezultoi se operatori ekonomik "Adem Pojani" kishte paraqitur disa dokumente, të cilat nuk përmbushnin kriteret e kërkuara, rrjedhimisht oferta u skualifikua. Nga shqyrtimi i dokumenteve të sistemit u konstatua se operatori ekonomik shoqëria "Alb-Star" sh.p.k. kishte paraqitur disa dokumente teknike dhe ligjore, por nga analizimi i tyre rezultoi se nuk kishte ofertë financiare dhe nuk plotësoheshin kriteret e kërkuara. Për këtë arsye, komisioni vendosi të skualifikojë operatorin "Alb-Star" sh.p.k. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin nga operatori ekonomik shoqëria "Gjoka Konstruksion", rezultoi se ajo kishte paraqitur dokumentacionin teknik, financiar dhe ligjor në përputhje me kërkesat e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe komisioni vendosi ta kualifikojë ofertën për fazën e vlerësimit. Gjatë fazës së vlerësimit, kjo ofertë u shpall fituese, pasi u trajtuan elementët e propozimit teknik për ndërtimin e rrugës dhe mirëmbajtjes, ndikimin mjedisor, ndikimin social, afatin e përfundimit të punimeve dhe ofertën financiare. Pas shpalljes se kompanisë fituese të garës, autoritetet shtetërore tashmë do të angazhohen për negociimin e kontratës koncesionare, firmosja e të cilës i hap rrugën përgatitjes së fillimit të punimeve në terren.

Intervista ndryshe e kryeministrit, flet për modën

Rama: Macron pëlqeu atletet e mia, kur të lë politikën, do dizenjoj rroba...

Një nga revistat e modës, "WWD", e cila konsiderohet si "Bibla e modës" ka realizuar një intervistë me kryeministrin Edi Rama, ku ka vënë në pah stilin e veçantë të veshjes të kryeministrit shqiptar. Artikulli i David Moin titullohet "Stili i pazakontë i kryeministrit shqiptar". Revista e nis shkrimin me atletet e famshme të Ramës në Samitin e Triestës. Sipas Ramës, lajmi kryesor i këtij samiti ishin pikërisht atletet e tij. "Praktikisht isha lajmi më i madh i samitit. Presidenti francez më tha se i pëlqyen atletet e mia, kështu që i dërgova një palë kur u ktheva në shtëpi. Por, për të i zgjedha me rripa blu dhe të kuq, për të kombinuar në mënyrë perfekte ngjyrat e flamurit francez", thotë Rama. Gazetari shkruan për Ramën se nuk është aspak një kryetar shteti i zakonshëm. Ai gjithashtu përmend faktin se Edi Rama ka luajtur basketboll deri në moshën 27-vjeçare, duke qenë pjesë e



Kombëtares. "Ne nuk kemi luajtur shumë, sepse ishim një vend i izoluar. E lashë basketbollin sepse u përfishiva totalisht në lëvizjen kundër regjimit komunist dhe kur Shqipëria u hap, unë dola të shoh botën. Kemi pasur më të mira vajzat e volejbollit", thotë Rama. Në fund të intervistës, Rama bën edhe një zbulim interesant. Ai thotë se kur të tërhiqet nga politika, do të dizenjoj rroba: "Gjithmonë kam thënë se do kem një jetë të tretë. E para ishte si artist, e dyta si politikan

dhe e treta do jetë një miks. Dua të dizenjoj këmbisha, pantallona e çorape, gjëra të vogla. Jo si biznes, por pak a shumë për vete dhe njerëzit që njoh. Jo për promovim masiv. Por kush e di? Gjithçka mund të ndodhë", thotë Rama. Në shkrimin e gjatë të "Women's Wear Daily", Rama i ka dhuruar gazetarit David Moin edhe një kravatë të stilarit sipas vizatimeve të tij: "Ende nuk e kam vendosur nëse do t'i komercializoj këto. Ndoshta në një jetë të tretë". Rama thotë se gjatë kohës që jetonte si artist i lirë në Francë, nuk e imagjinonte veten në politikën zyrtare: "Unë u bera i famshëm për shkak të aktivizimit në politikë. Isha një lloj Michael Moore. Çfarë mendoni për të? Ai nuk është politikan, por është shumë i lidhur me politikën. Gjithmonë e kam menduar se një qytetar i angazhuar në art apo që është figurë publike e ka obligim të përfshihet", thotë Rama.

REFORMA ZGJEDHORE RAPORTI

Raporti i OSBE mbërrin në KQZ, kreu Zguri: Plotësojmë rekomandimet

"Zgjedhja", OSBE/ODIHR: Përmirësoni sistemin, bashkëpunim mes palëve

Tejler: Dialog, përmbushni detyrimet

Valentina Madani

Misioni i OSBE-ODIHR-it nisi dje takimet me politikanët shqiptarë për raportin e zgjedhjeve të 25 qershorit dhe çështjen e reformës së re elektorale. Kreu i këtij misioni, z.Peter Tejler takoi dje ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, ku ky i fundit i cilësoi zgjedhjet e 25 qershorit si më të mirat të zhvilluara në periudhën pas tranzicionit, pas marrëveshjes politike të 18 majit. Bushati vlerësoi ngritjen e Komisionit parlamentar për Reformën Zgjedhore si dhe shpreson që fryma e konsensusit politik të vijojë deri në realizimin e saj. Ministri Bushati i bëri me dije delegacionit të OSBE/ODIHR, se forcat politike në Shqipëri kanë shprehur vullnetin e tyre për të zhvilluar një reformë zgjedhore të thellë dhe të gjithanshme në vend, për çka kanë ngritur edhe komisionin e posaçëm parlamentar për zhvillimin e kësaj reforme. Është me interes që fryma e konsensusit politik për reformën zgjedhore të vijojë deri në realizimin e saj, në prag të zgjedhjeve të ardhshme vendore. Ministri Bushati përsëriti edhe nismën e BE-OSBE/ODIHR për zhvillimin e një reforme të sistemit zgjedhor në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor; çka do t'i shërbejë edhe reformës së nisur në Shqipëri. Ambasadori Tejler falënderoi Qeverinë shqiptare për mbështetjen e dhënë në përmbushjen e misionit të tyre të vëzhgimit të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare në Shqipëri, si dhe për mundësinë e krijuar për prezantimin e raportit final të OSBE/ODIHR. "Ne e vlerësojmë - tha ai - zhvillimin e debatit në vend për përmirësimin e sistemit zgjedhor; ngritjen e komisionit të posaçëm



Kreu i Misionit të OSBE-ODIHR-it z.Peter Tejler, dje me ministrin Ditmir Bushati

parlamentar për zgjedhjet, për të ndërmarrë reformën e duhur zgjedhore, në bazë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR. Ambasadori Tejler u shpreh se OSBE/ODIHR është e gatshme të bashkëpunojë me të gjithë aktorët në Shqipëri për realizimin e reformës zgjedhore në vend. Po dje, kryetari i KQZ-së, Klement Zguri dhe zëvendëskryetari Denar Biba pritën në një takim delegacionin e OSBE/ODIHR, ambasadorin Peter Tejler, kryetar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve; zj. Ana Rusu, këshilltare e lartë për zgjedhjet dhe z. Alexey Gromov, këshilltar për zgjedhjet. Në takim u diskutua mbi gjetjet

dhe rekomandimet e raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 qershor 2017. Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vlerësoi se raporti i OSBE/ODIHR-it është mjet pune dhe se duhet të jetë në vëmendjen e të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor. Zguri u shpreh se KQZ-ja është e angazhuar në plotësimin e rekomandimeve, të cilat i janë adresuar institucionit që ai drejton. Edhe kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, 4 muaj pas përfundimit të zgjedhjeve i shprehu vlerësimet kreut të misionit të ODIHR, Peter Tejler për përfundimet e rapor-

MBESHTETJA

Ambasadori Tejler tha se: "Ne e vlerësojmë zhvillimin e debatit në vend për përmirësimin e sistemit zgjedhor, ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar për zgjedhjet, për të ndërmarrë reformën e duhur zgjedhore, në bazë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR.

tit për 25 qershorit, i cili sipas liderit të selisë blu dokumento shqetësimet ngritura nga opozita. Basha vlerësoi që shqetësimet si shpërblim apo përdorimi i administratës në shërbim të pushtetit janë tashmë pjesë e këtij raporti. Nga ana tjetër; Basha theksoi se reforma zgjedhore është prioritet për Partinë Demokratike dhe kërkoi që OSBE të asistojë me ekspertizë për këtë reformë, në mënyrë që rekomandimet të implementohen, duke nisur nga votimi dhe numërimi elektronik. Ambasadori Tejler zhvilloi një takim edhe me kryetaren e Lëvizjes Socialiste për Integritet të Shqipërisë, Monika Kryemadhi, e cila vlerësoi po ashtu sensin realist të raportit, ku konfirmohen një pjesë e probleme si shpërblim dhe votë, përfshirja e policisë në zgjedhje, ndikimi i eksponeve kriminale në votime, etj. Sa për reformën zgjedhore, konsensusi dhe transparencja u cilësuan si kushte të domosdoshme për të krijuar besimin e qytetarëve tek procesi zgjedhor. Kryemadhi u shpreh se duhet të nisemi nga rekomandimet e ODIHR për të krijuar një sistem zgjedhor, ku garantohej liria dhe barazia e votës.

Debate te 'Ligjet', largohen anëtarët e PD

Komisioni i Ligjeve u shpërndarë me debate të forta dje mes mazhorancës dhe opozitës, çka bëri që anëtarët e djathtë të largohen nga mbledhja. Deputeti demokrat, Eduard Halimi, hodhi akuza të shumta ndaj anëtarëve të majtë, teksa ka deklaruar se shteti dhe krimi janë bërë një. Duke sjellë sërish në vëmendje rastin e Habilajve, Halimi deklaroi se ky rast tregoi se shteti është kapur në flagrancë, ndërsa qeveria është bërë avokate e Habilajve dhe jo e Zaganit. "Shteti dhe krimi janë bërë një. Rasti i Habilajve tregon se shteti është kapur në flagrancë. Jeni bërë avokatë të Habilajve, jo të Zaganit. Kjo është marrëveshja më e rëndë, krimi bleu zgjedhjet", theksoi deputeti i Partisë Demokratike Halimi.



Gjatë një Seance parlamentare



Kryemadhi: Kriminelët ndikuan në votime

Kryetaria e LSI, Monika Kryemadhi, u ankua dje të OSBE-ODIHR se kriminelët ndikuan në votimet e 25 qershorit. Ajo priti kreun e Misionit të ODIHR-it për zgjedhjet, Peter Tejler, i cili prezantoi raportin e ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare. Gjatë fjalës së saj, Kryemadhi vlerësoi sensin përgjithësisht realist të raportit, ku konfirmohen një pjesë e problemeve që janë ngritur para zgjedhjeve siç janë shpërblimja e votës, përfshirja e policisë në zgjedhje, ndikimi i eksponeve kriminale në votime dhe cenimi i së drejtës së qytetarëve për një proces zgjedhor, ku garantohej vullneti i tyre për të mbështetur lirisht partinë politike që përfaqëson më mirë pikëpamjet e tyre. Gjatë bashkëbisedimit u diskutua edhe për rekomandimet e OSBE-ODIHR për reformën zgjedhore, ku konsensusi e transparencja u cilësuan si kushte të domosdoshme për të krijuar besimin e qytetarëve të procesit zgjedhor. Për sa i përket sistemit zgjedhor, Kryemadhi tha se duhet të nisemi nga rekomandimet e ODIHR-it për të zgjidhur problemet e sistemit në të kaluarën, si dhe marrjen e shembujve më të mirë nga vendet e tjera, ku garantohej liria e barazia e votës së qytetarëve.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pajisje kancelarie, letër format A4 dhe bojë/shiritë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,200,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pajisje kancelarie, letër format A4 dhe bojë/shiritë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **23 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

STRATI Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njëfiton shpalljen për shitjen në ankaad të pasurive të paluajtshme:

"-Truall", me sipërfaqe 3200 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 13, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteko nr. 448 Rep., Nr. 211/3 Kol., datë 02.02.2006. Çmimi fillestar i ankandit është 89.800 Euro;

"Truall" së bashku me depozitë karburanti, me sipërfaqe 4419 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 14, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteko nr. 448 Rep., Nr. 210/3 Kol., datë 02.02.2006. Çmimi fillestar i ankandit është 162.036 Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 06.11.2017. Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com



Kreu i PD: Antimafia konfirmoi shitblerjen e votës me paratë e krimit

Trafiku i drogës, Basha: Beteja jonë, Tahiri para drejtësisë

"Krimi ka kapur shtetin, pushteti në duart e bandave"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzoi dje qeverinë e kryeministrit Edi Rama si të lidhur me krimin dhe drogën, duke çuar bizneset drejt falimentimit dhe ka varfëruar njerëzit. Sipas Bashës, beteja e opozitës është çuarja para drejtësisë e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, si mbështetës dhe përfitues i trafikut të drogës. "Beteja jonë për dekriminalizimin e shtetit, për vënie para drejtësisë të Saimir Tahirit si mbështetës dhe përfitues i trafikut të drogës është shtetëtare me jetike për shqiptarët. Sepse krimi ka kapur shtetin, varfëria dhe mjerimi ka pushtuar anembanë vendin, papunësia dhe pamundësia po shtyn drejt emigrimit mijëra të rinj e intelektualë. Opozita është në krahun e njerëzve. Rama dhe qeveria e tij janë të zhytur në krim dhe të kapur nga krimi, janë problemi dhe jo zgjidhja", theksoi z.Basha. Sipas kreut demokrat, politika e kryeministrit Rama është e drogës dhe e krimit dhe e se kjo politikë ka çuar në falimentonim e 30 mijë bizneseve. "Politika e Edi Ramës është krimi dhe droga. Është politika e tij, që ka çuar 30 mijë biznese drejt falimentimit, mbylljes së mijëra vendeve të punës, rritjen e çmimeve dhe zhytjen e shqiptarëve në varfëri. Politika e Ramës bëri që 30% e familjeve shqiptare nuk sigurojnë dot bukën e fëmijëve, 39% e shqiptarëve nuk paguajnë dot faturën e dritave dhe ujit, 43% e familjeve nuk sigurojnë dot ngrohjen për fëmijët", theksoi z.Basha.

TAKIMI
Kreu i PD-së priti dje në një takim kreun e delegacionit të vëzhguesve të OSBE-ODHIR për zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017, Peter Tejler mbi përfundimet e raportit të misionit. Në një takim të PD, thuhet: "Kreu i opozitës e konsideroi shumë të rëndësishëm raportin, i cili ka dokumentuar shqetësimet ngritura nga opozita. Raporti konstaton shkelje të rënda, të cilat kanë deformuar vullnetin e shqiptarëve, duke nisur nga shitblerja e votës, presioni mbi zgjedhësit, presioni mbi administratën dhe mbi biznesin, përdorimi masiv i shtetit në shërbim të partisë në pushtet,



Kreu i PD-së gjatë takimit të djeshëm me kreun e delegacionit të vëzhguesve të OSBE-ODHIR

tet, cenimin e lirisë dhe sekretit të votës, etj.", deklaroi z.Basha. Më tej, në një takim të PD thuhet: "Raporti evidenton se individë me rekorde të tmerrshme kriminale luajtën një rol domethënës në fushatë. Kjo u vu re edhe gjatë ditës së zgjedhjeve në bashkëpunimin e kontingentit kriminal me shtabet e partisë në pushtet. Kryetari i opozitës nënvizoi faktin se përgjimet e Antimafias italiane konfirmojnë se roli i krimit dhe parave të drogës në shitblerjen e votës dhe kërcënimin e votuesve përbën problemin më të madh të demokracisë dhe

zgjedhjeve të lira në vend". Basha vlerësoi që këto shqetësime janë tashmë rekomandime prioritare nga OSBE/ODHIR-it. Ai u shpreh se reforma zgjedhore është prioritet për Partinë Demokratike dhe është kërkuar të nisë puna menjëherë me nisjen e sesionit të ri parlamentar. Gjithashtu, vonesat dhe mungesa e vullnetit nga ana e qeverisë mund të cenojë procesin për një hartuar një reformë tërësore. Kreu i opozitës kërkoi mbështetjen dhe ekspertizën e misionit të OSBE/ODHIR-it për implementimin e rekomandimeve. Re-

forma zgjedhore duhet të përballët me shumë prej problematikave të shumta të procesit si lista e zgjedhësve, sistemin e adresave, përdorimin e financimeve dhe individëve me rekorde kriminale, përdorimin e pushtetit, votën e emigrantëve dhe mbi të gjitha, shitblerjen e votës. Votimi dhe numërimi elektronik është kërkesa dhe kushti parësor i opozitës shqiptare. Kreu i opozitës tha se votimi dhe numërimi elektronik do të eliminojë shumë prej problemeve. Basha tha se Partia Demokratike kërkon me ngulm një reformë tërësore, që jo vetëm të adresojë e të zgjidhë problemet e mëdha të procesit, por edhe të fuqizojë të drejtën e qytetarëve për të vendosur dhe të kufizojë pushtetin e kryetarëve të partive. Po ashtu, ngritja e një institucioni të pavarur nga qeveria për të ndaluar presionet dhe abuzimet mbi administratën është e domosdoshme, ashtu si ndjekja dhe penalizimi fort i çdo rasti të evidentuar për shitblerje vote. Kryetari Basha mori mbështetjen e ambasadorit Tejler për një bashkëpunim të plotë me OSBE/ODHIR-in, me ekspertët e tyre më të mirë për të asistuar në hartimin e reformës zgjedhore.

KUSHTET

Votimi dhe numërimi elektronik është kërkesa dhe kushti parësor i opozitës. Sipas Bashës, votimi dhe numërimi elektronik do të eliminojë shumë prej problemeve. Basha tha se PD kërkon me ngulm një reformë tërësore, që jo vetëm të adresojë, por edhe të zgjidhë problemet e mëdha të procesit".



Ish-kryeministri Sali Berisha

Ish-kryeministri: Krimi që fsheh policia

Berisha: "Biseda e errët" e Ramës me të dërguarin e Tahirit

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje "bisedën e errët" të kryeministrit Edi Rama me biznesmenin Gaz Demi, të cilin e quan ndërmjetës të ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. "Punonjësi dixhital informon se sot në zyrën e tij, Edvini pati një takim me Gaz Demin, ndërmjetësin famoz, me të cilin Saimir Tahiri kërcënoi natën e 'Opinionit' Ramën për publikimin, në rast se do ta lëshonte, të 5 dosjeve kundër tij dhe narko-pushtetarëve të tjerë", tha Berisha në një postim në rrjetet sociale. Ai shtoi se, "në rast se dihet se Gazi sot ishte përsëri i dërguari i Saimirit, biseda e zgjatuar e tij me Ramën mbetet e errët!". Prokuroria për Krime të Rënda kërkoi autorizim nga parlamenti për arrestimin e deputetit socialist, Saimir Tahiri, por Kuvendi me votat e socialistëve i dha leje vetëm për vazhdimin e hetimit dhe kontrollin personal dhe të banesës. Po dje, z.Berisha duke iu referuar burimeve të tij nga qytetari dixhital njoftoi se një grua ka vdekur në Tepelenë, pasi ka qenë duke pastruar hashashin dhe policia e ka fshehur këtë ngjarje. "Qytetarët dixhitalë informojnë vdekjen e punëtorese së kanabisit në kullën e Qerem Braçit! Policia mban të fshehtë vdekjen", shkruan z.Berisha. Ai zbardh mesazhin e qytetarit dixhital: "Përshëndetje z.Berisha, ai Qerem Braçi i famshëm i Gramoz Ruciç, dy ditë para se të digte kapononin e tij i ka vdekur një zonjë që ka qenë duke qelur hashash dhe bashkë me kryetarin e degës, Emiljanon, e kanë çuar në spitalin e Gjirokastër sikur ka qenë me tension. Ka pasur shumë gra të tjera prezente, që e kanë parë atë çfarë ka ndodhur. Jepua pak këtë lajmë atyre kuqoqe që t'i fusin brenda këta bastardë trafikantë".

PD, Tabaku: Qeveria, rrëmben ç'të mundet dhe gënjen për gjithçka!

Deputetja demokrate, Jorida Tabaku akuzoi dje se 'ByPass'-i i Fierit tirit ditën dhe prishet natën, "si simbol i vërtetë i qeverisjes socialiste, rrëmbe ç'të mundesh dhe gënje për gjithçka". Ajo shkruan në "Facebook" se: "këto ditë qeveria rihapi tenderin për 'ByPass'-i Fier-Vlore. Mbas për dy vite dështoi të bëjë mbi 10 për qind të punimeve, e rifilloi përsëri nga fillimi projektin prej 60 milionë euro". Ajo përmendi: "Për të kuptuar më mirë raportin mes qeverisë socialiste dhe investimeve në rrugë, shkolla dhe cerdhe, kjo shkelje u faktua edhe nga institucioni i KLSH". Sipas saj, projekti 'ByPass' Fier-Vlorë ka qenë një nga subjektet që ka sjellë demin ekonomik më të madh në



Deputetja demokrate, Jorida Tabaku

buxhetin 2016. Plot 13 milionë euro të taksapaguesve janë logaritur si dëm ekonomik, ndërsa rruga është shtuar me vetëm 500 metra nga pika e lënë në 2013. "Këto ditë, ministria përkatëse ka rinisur tenderin për një segment rrugë që duhet të kishte për-

funduar me kohë. Ka katër vjet që rruga ka mbetur si pëlhuera e Penelopës, tirit ditën dhe prishet natën, si simbol i vërtetë i qeverisjes socialiste, rrëmbe ç'të mundesh dhe gënje për gjithçka!", shprehet deputetja e PD-së.

Qyqarët, paguanin deri në 20 mijë dollarë për punësim në Kanada

TIRANE

Prokuroria e Tiranës ka kërkuar dënimin me 18 vite burg në total për Lule Makashi dhe vajzën së saj Adela Makashi, pasi kanë mashtruar qytetarët me vizat e punësimit në Kanada. Përkatesisht 10 vite burg për të pandehurën Lule Makashi dhe 8 vite burg për të bijën.

Mësohet se 360 shqiptarë kanë paguar diku te 20 mijë dollarë për viza pune në shtetin kanadez, pa marrë asgjë në këmbim, të mashtruar nga dy të akuzuara. Pas denoncimit të bërë nga 27 persona në qytete të ndryshme të vendit, Seksioni për Krimin Ekonomik-Financiar në policinë e Tiranës zbardhën një skemë mashtrimi. Policia shqiptare njoftoi autoritetet kanadeze për shpalljen në kërkim të Lule Makashi dhe vajzës së saj, pas arrestimit të bashkëpunëtorit të tyre, Klevis Rreshka. Më tej autoritetet kanadeze bënë anulimin e vizave për këto dy shtetase për t'i rikthyer në Shqipëri. Në momentin që nënë e bijë kanë mbërritur në tokën shqiptare, janë transportuar në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ku janë marrë në pyetje veçmas nga njëra-tjetra.

Mashtrimi për vizat, prokuroria: 18 vite burg për nënë e bijë


Lule Makashi dhe e bija zhvatën 360 aplikantë

ARRESTIMI

Në momentin që nënë e bijë kanë mbërritur në tokën shqiptare, janë transportuar në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ku janë marrë në pyetje veçmas nga njëra-tjetra.



Lule dhe Adela Makashi



DOSJA E PROKURORISE

Nga studimi i të dhënave të dokumentuara nga Policia Gjyqësore dhe verifikimet e bëra rezultoi se në datën 25.04.2016 në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë janë paraqitur dhe kanë bërë kallëzimin 26 shtetas. Ata kanë shpjeguar se kanë aplikuar në vitin 2014, për punësim dhe studime pranë shoqërisë

ANDE-LM me administratore shtetasen L. M. që ndodhet me seli në rrugën "Is-mail Qemali" Tiranë.

Personat që aplikojnë, pasi dorëzonin dokumentet që kërkonte kjo shoqëri, ishin në pritje për të dalë viza, dhe shtetasja L.M. ka organizuar dhe takime të ndryshme në hotel me persona që janë prezantuar si avokatë kanadezë, duke shpjeguar dhe pro-

cedurat e marrjes së vizës së aplikantëve. Shtetasit që kanë aplikuar dhe kanë dorëzuar dokumentet për pajisjen me vizë, kanë paguar në llogari të shoqërisë "Ande-LM" Sh.PK, shuma të konsiderueshme në lekë dhe valutë. Pasi kanë shkruar në datë 25.04.2016 pranë zyrrave të kësaj shoqërie, kanë mësuar se shtetasja L.M. së bashku me vajzën e saj ishin larguar jashtë shtetit. Bëhet me dije se kjo shoqëri i ishte lënë në administrim shtetasit K.RR.. Më pas uniformat blu kanë ushtruar kontroll në zyrat e shoqërisë Ande-LM, ku është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një sasi e madhe me dokumentacion aplikimesh dhe refuzimesh të përpiluara nga kjo zyrë si dhe kompjuterë që kanë shërbyer për aplikime apo për mbajtjen e të dhënave.



Gjyqi ndaj Emiljano Shullazit, shtyhet seanca te Krimet e Rënda

TIRANE - Në Gjykatën e Krimeve të Rënda është shtyrë dje seanca ndaj Emiljano Shullazit. Shkak i kësaj shtyrje është bërë mungesa e një gjyqtari për arsye familjare. Mësohet se gjyqtari kishte humbur babain e tij. Ndërkohë edhe në 24 tetor seanca u shty për shkak të mungesës së dy prokurorëve, Elisabeta Imëraj dhe Emed Nakuçi. Mungesën e tyre në seancë ata e justifikuan me një shkresë në të cilën shkruanin se për "arsye objektive" nuk mund të ishin të pranishëm. Për çështjen 'Shullazi' kanë dëshmuar një sërë figurash të njohura publike, që nga ministri Nikolla, ish-ministri Saimir Tahiri, por edhe rektori i UT-së Mynyr Koni, i cili dyshohet se është kërcënuar nga Emiljano Shullazi gjatë kohës që ai garonte për këtë post.



The United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) Representation in Albania is looking for a:

"SENIOR PROTECTION ASSOCIATE"

Terms of Reference for this position can be found on: www.un.org.al at the section of "Employment and Procurement".

Interested candidates should send the following documents (in English):

- Update P11 entry form and
- Motivation Letter

to, albt@unhcr.org or in the sealed envelope addressed to: UNHCR Albania, Skenderbej Street, Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania, referring to the External Vacancy Notice: UNHCR/ALB/TIR/17/GS/02, by 14 November 2017, 5:30 p.m. CET.

E reja: Marjo më tha: Këtu s'të gjen njeri, të vras

Mori peng dhe torturoi 21-vjeçaren nga Ukraina, arrestohet i riu nga Durrësi

DURRËS - Policia e Durrësit ka vënë në pranga një të ri nga Durrësi pas denoncimit të një 21-vjeçareje nga Ukraina. E reja me inicialet V.H. ka rrëfyer gjithçka para uniformave blu të Durrësit, që nga njohja me Almarjo Xhebexhian deri te dhuna dhe dyshimet se do e prostituoonte. Ka qenë pikërisht frika nga kjo gjë që e ka shtyrë ukrainasën të denonconte 24-vjeçarin. Nga zbardhja e dëshmisë së dhënë në polici të 21-vjeçares, rezultoi se ajo dhe Marjo ishin njohur në Mal të Zi kur kishin qenë me pushime gjatë verës dhe kishin mbajtur kontaktet deri sa ai e kishte ftuar të vinte në Durrës. "Para disa muajsh u njoha me Marjon në Malin e Zi, ku ishim për pushime. Shkëmbyem numrat e telefonit dhe adresat tona dhe filluam të flisnim me njeri-tjetrin në "Facebook" dhe whatsapp. Sa vinte dhe bëheshim më të lidhur me njeri-tjetrin. Më pas Marjo më ftoi në Shqipëri si të dashurën e tij duke më kërkuar të njiheshim më shumë. Meqenëse unë



DËSHMIA E 21-VJEÇARES

"Para disa muajsh u njoha me Marjon në Malin e Zi, ku ishim për pushime. Marjo më ftoi në Shqipëri si të dashurën e tij duke më kërkuar të njiheshim më shumë. Kam ardhur disa herë. Si fillim u tregua i dashur, i mirë dhe më pas nisën episodet e dhunës. Pardje më çoi në hotel dhe më dhunoi", -ka dëshmuar e reja nga Ukraina.

nuk dyshoja tek ai për asgjë të keqe, erdha në Shqipëri. Kam ardhur disa herë. Si fillim u tregua i dashur, i mirë dhe më pas nisën episodet e dhunës. Pardje më çoi në hotel dhe më dhunoi. Më ka rrahur në mënyrë brutale. Më kërcënohte se do më vriste. 'Do të vras dhe këtu s'të gjen njeri' -më thoshte. Nuk e di pse më kërkonte të rrija në Durrës.

Nuk e di çfarë qëllimi kishte", -ka dëshmuar e reja nga Ukraina. Pas denoncimit të saj policia prangosi 24-vjeçarin Almarjo Xhebexhia, i cili akuzohet se ka ushtruar dhunë fizike, duke i shkakuar dëmtime të rënda, si dhe e ka mbajtur pa dëshirën e saj të mbyllur në dhomën e hotelit 21-vjeçarën nga Ukraina.

Prokuroria e Katanias: Banda trafikoi 20 milionë euro drogë e armë

Gjyqi ndaj Habilaive, avokati: Tahiri s'figuron në dosje

Kreu i grupit kriminal mohon akuzat, duke kërkuar lirimin

Ina Allkanjari

Grupi i Habilaive doli mëngjesin e djeshëm përpara Gjykatës së Rivlerësimit të Katanias. Gjatë seancës u morën në shqyrtim ankimmimet e bëra nga 6 prej 7 anëtarëve të arrestuar të kësaj bande kriminale, ndaj të cilëve rëndon akuzat e trafikut ndërkombëtar të drogës. Të pandehurit ranë në pranga pas hetimit të njohur në Itali si "Rosa dei Venti". Grupi Habilaj doli para tre gjyqtarëve larato, Benanti dhe Catena të Gjykatës së Katanias, ndërsa prokuroria bëri dje publike detaje nga dosja hetimore ku nënvizohet se grupi Habilaj ka trafikuar nga Shqipëria në drejtim të Italisë lëndë narkotike në vlerën e 20 milionë euro. Mësohet se Moisi Habilaj, i dyshuari si kreu i grupit të trafikut ndërkombëtar është paraqitur i fundit përpara gjyqtarëve. Avokati i tij Bia-

EMRI I SAIMIR TAHIRIT NË DOSJE

Avokati italian i Moisi Habilaj, Biagio Maurizio Catalano shprehet se përmendjen e emrit të ish-ministrit Saimir Tahiri në dosje e ka dëgjuar vetëm në media. Sipas tij, deri më tani nuk rezultojnë përfshirja e ndonjë politikani.



gio Maurizio Catalano, konfirmoi se Habilaj i ka mohuar akuzat, duke kërkuar lirimin. "Prokuroria kërkoj që të konfirmohet urdhri për mbajtjen e tyre në burg. Ndërsa ne kërkuam anulimin për mungesë provash. Kjo është pikënisja ndaj s'mund të themi saktësisht se si do të shkojnë gjërat. Vetë urdhri i ndalimit, për të cilin besoj se jeni në dijeni, sepse është pub-

likuar, mendoj se është maja e ajbsbergut, përmblodhje e një fashikulli të tërë dosjesh voluminoze hetimesh, të cilën unë vetë nuk kam pasur kohë të konsultohem. Por në këtë fazë, faza e parë së paku këtu në Itali, është ajo për t'ju drejtuar Gjykatës së Lirisë, për të pasur së paku një prej pozicioneve, pra nga ky moment, mund të

lëshohet dhe t'i rikthehet liria së paku ndonjërit", -u shpreh Biagio Maurizio Catalano, avokati. Në lidhje me përmendjen e emrit të ish-ministrit Saimir Tahiri në këtë dosje, avokati italian i Moisi Habilaj, shprehet se deri më tani nuk rezultojnë përfshirja e ndonjë politikani në këtë dosje. Mësohet se avokati Biagio Maurizio

Catalano mbron edhe dy të arrestuarit e tjerë shqiptarë, Meridan Sulajt dhe Fatmir Minajt. "Për këtë figurë, për ish-ministrin më kanë folur të tjerët, por jo aktet. Mua nga aktet nuk më rezultojnë as edhe një presje. Ndaj objektivisht duhet të flas për një gjë që e kam dëgjuar nga jashtë procesit dhe jo brenda procesit. Mua s'më ka

ndodhur ta takoj asgjëkund, nuk ekziston të paktën nga aktet që kam konsultuar unë. Por më duhet ta rithem, bëhet fjalë për një pjesë shumë të vogël të përmblodhjes, më pas në pjesën tjetër nuk e di se çfarë mund të ketë. Deri në këtë pikë, mua s'më rezultojnë asgjë për ndonjë autoritet politik apo ndonjë tjetër", -tha avokati Catalano. Ndërkohë i vetmi nga të arrestuarit që nuk ka kërkuar rishikimin e arrestimit ishte italianii Antonino Riela, i cili sipas dosjes së hetimit rezultojnë të jetë një nga kontaktet më të besuara në Catania të Moisi Habilaj. Tashmë pritet që Gjykata e Katanias deri në datën 3 nëntor të vendosë lidhur me fatin e të arrestuarve. Sakaq Policia e Katanias, thekson se agjentët italianë kanë marrë pjesë në arrestimin e Nezar Seitit, i cili është një prej 4 shqiptarëve që nuk u kap në territorin italian, por që ishte në kërkim me një urdhër arrest ndërkombëtar.



British American Tobacco Albania sh.p.k.

Njofton se duke filluar nga data 06.Nëntor 2017, cmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do të jenë si vijon:

Nr	MARKA	Cmimi maksimal/pakete i shitjes me pakicë
1	Kent Nanotek (Infina)	300
2	Kent Demislms Neo	280
3	Kent Demislms Spektra	280
4	Kent HD Neo	300
5	Kent HD Infina	300
6	Kent HD Neo 10 cigare	150
7	Lucky Strike Red	230
8	Lucky Strike Blue	230
9	Like Strike Blue 10 cigare	120
10	Lucky Strike NFF King Size 6 mg	230
11	Lucky Strike NFF Demislms 6 mg	220
12	Lucky Strike NFF King Size 4 mg	230
13	Lucky Strike NFF Demislms 4 mg	220
14	Rothmans Leggera	230
15	Rothmans of London (Blue)	200
16	Rothmans of London (Sky Blue)	200
17	Rothmans of London (Silver)	200
18	Dunhill FC 7 mg	320
19	Dunhill FC 4 mg	320
20	Rothmans of London Demislms 6mg (Produkti i ri)	200
21	Rothmans of London Demislms 4mg (Produkti i ri)	200

*Cmimet shprehën në Lek

Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

British American Tobacco Albania sh.p.k.
Tirane, Rr:"Kavajes", ish Kombinati Ushqimor
web: www.bat.com
office phone: +355 (0) 42 255084

Policia: Dyshohet se janë përfituar nga aktiviteti kriminal

Sekuestrohen pasuri të vëllezërve Habilaj, tri apartamente dhe njësi shërbimi

VLORE - Policia e Vlorës në bashkëpunim me prokurorinë ka sekuestruar prona dhe pasuri të patundshme të vëllezërve Artan, Moisi dhe Florjan Habilaj për llogari të hetimeve të drejtësisë shqiptare dhe asaj italiane, pasi dyshohet se janë përfituar nga burime financimi të paligjshme, kryesisht nga veprimtari kriminale. Mësohet se sekuestro është vendosur pas procedimit penal ndaj vëllezërve Habilaj, të cilët janë kushërinj të largët të Saimir Tahirit përmendin edhe emrin e ish-ministrit, ndërsa opozita e akuzon këtë të fundit se është i implikuar në trafikun e drogës. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë Vendore të Vlorës dje bënë me dije se në vijim të informacionit, lidhur me procedimin penal në ngarkim të shtetasve: Artan Habilaj, Moisi Habilaj dhe Florjan Habilaj, si persona të dyshuar për kry-



erjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", është bërë ekzekutimi i Vendimit Penal Nr. 379 datë 30.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka vendosur caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro-preventive" mbi pasuritë e mëposhtme: Njësi Shërbimi me sipërfaqe 157 m², ndodhur në lagjen "28 Nëntori", Vlorë, në pronësi të shoqërisë "Turi&Mzb" sh.p.k dhe Florjan Habilaj; njësi shërbimi me sipërfaqe 136 m², në lagjen "29 Nëntori", Vlorë, në pronësi të shtetasit Florjan Habilaj; apartament banimi në Vlorë, në pronësi të

shtetasit Artan Habilaj; apartament banimi me sipërfaqe 69 m², në lagjen "Uji i Ftohtë", në pronësi të K.H.; apartament banimi me sipërfaqe 104.5 m² në Vlorë, në pronësi të shtetasit F.M. dhe njësi shërbimi dhe banimi, me sipërfaqe 156 m², në Vlorë, në pronësi të shtetasit Artan Habilaj. Vijon puna për evidentimin dhe sekuestrimin e pasurive të tjera që kanë buruar nga aktiviteti kriminal. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Miratohet buxheti në Konferencën e Kryetarëve. Rama: Politika jonë është puna

Ornela Manjani

Çmimi i cigareve do të rritet sërish pas janarit, kjo pasi qeveria do të rrisë sërish akcizën për duhanin. Kjo u konfirmua nga ministri i Ekonomisë dhe Financave Arben Ahmetaj, teksa prezantoi projektbuxhetin e 2018-ës pranë Konferencës së Kryetarëve. "Akciza e cigareve do të rritet. Duhej të ishte 10 lekë për paketë, por kemi menduar një rritje pak më të butë, 7 lekë për paketë", tha Ahmetaj. Ministri detajoi aksionin e qeverisë për kompensimin e pronarëve dhe vjedhësit e ujit. "40 milionë dollarë, 4 miliardë lekë çdo vit të vendosur me një trajektore ngjyeshme për të shkuar 5 miliardë lekë në vitet që vijnë për të kompensuar pronarët. Reforma e ujit pas asaj të energjisë do të fillojë në janar", u shpreh Ahmetaj. Sipas ministrit të Financave, bizneset vërtetë të vegjël do të ngelen jashtë skemës së TVSH-së. "Pragu i TVSH do të fusë në skemë 11 mijë taksapagues, 216 mijë do ngejin të përjashtuar, ata që janë realisht të vegjël", tha Ahmetaj. Ministri tha se ky projektbuxhet do të ulë borxhin publik. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj deklaroi sot në Konferencën e Kryetarëve se

"Buxheti 2018", rritet akciza e duhanit, 7 lekë për paketë

Taksa e shtëpive, ndërtime para 1993-shit do paguajnë më pak



Foto nga konferenca e kryetarëve

do të ketë një diferencim të taksës për banesat e ndërtuara para vitit 1993. Këto të fundit do të kenë një taksë më të ulët. Në fjalën e tij, Ahmetaj tha se tashmë me reformën e re do të bëhet një kalim nga taksimi fiks të vlera e tregut. Po ashtu, si

pas tij do të ridimensionohet edhe kadastra fiskale.

REAGIMI I RAMËS

Kryeministri Edi Rama ka reaguar në "Twitter", duke iu përgjigjur akuzave të PD dhe LSI lidhur me projektbuxhetin 2018. Opozita bojkoti sot mbledhjen e Kon-

ferencës së Kryetarëve, ku do të prezantohej drafti nga ministri i Financave, Arben Ahmetaj, pas debateve me mazhorancën për çështjen e drogës. PD dhe LSI kërkuan që prezantimin e buxhetit ta bënte kryeministri Edi Rama, kërkesë kjo e artikulo-

uar edhe nga kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, gjatë një konference për mediat. Por në një reagim në rrjetet sociale, Rama sqaroi se qeveria do të donte debat me përgjegjësi, por sipas tij, ftesa që ka ardhur ka qenë ajo për sherr politik. "Do donim debat me përgjegjësi për projektbuxhetin 2018, po kemi vetëm ftesën e vjetër për sherr politik! Politika jonë është puna, jo sherrit", shkruan Rama në rrjetet sociale.

INVESTIMET

Ministri Arben Ahmetaj përsëriti se projektbuxheti i vitit të ardhshëm është buxheti i vazhimit të rritjes ekonomike. "I rritjes së investimeve publike, rritjes së të ardhurave, uljes së borxhit publik, mbështetjes së reformave dhe vazhimit të kon-

solidimit fiskal", tha Ahmetaj. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj përsëriti prioritetin tek investimet në infrastrukturë. Ai thotë se përparësi do të kenë akset me rëndësi kombëtare dhe është duke u diskutuar mes Ministrisë së Financave dhe asaj të Infrastrukturës për një listë të projekteve që do të përfitojnë financim. Sa u takon të ardhurave, Ahmetaj u shpreh se në 2017-ën parashikohet një rritje prej 28.1 për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto, rritje që kreu i Financave thotë se nuk bazohet tek rritja e taksave. "Rezultat i përmirësimit administrativ dhe i luftës kundër informalitetit. Nuk bazohet në rritje taksash, por përkundrazi në disa sektorë kemi pasur ulje të taksave", deklaroi ai.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇEM I APELIMIT

SHPLLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikë dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelit", shpall vendet vakante për pozicionet:

1. SPECIALIST FINANÇE/BUXHET

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

2. SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

3. SPECIALIST IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panellet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

4. SPECIALIST PROTOKOLL/ARKIVE

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze

- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certificate Sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda tre muajve për këstin e parë dhe të dytë

Ornela Manjani

Ish-të përndjekurit, 3000 trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblim

Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve të plotësojnë dosjet

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politike që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë jo parësore, për trashëgimtarët, rreth 3000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjen me dokumente.

"Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë, së bashku me analizën e dokumentacionit për çdo dosje, si për përfituesit e kështit të parë, ashtu edhe për ata të kështit të dytë. Dokumentet për trajtimin me dëmshpërblim pas shqyrtimit të juristit, duhet të dorëzohen brenda tre muajve.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi

ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, goftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë

që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligi parashikon edhe

rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt

vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", - thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E PARË

SHENIM: Jë dokumentacioni është i rregullt shenohet me V, kur mungon shenohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shenohet me P.

NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFITIM	NUMER PERSONAL LLOGARINË BANCARE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILIAR	DESIMI TRASHIGTIME	PROKURE
3914	PRENG	NIKOLLI		SHKURT					V	V	V
				DILE NIKOLLI					V	V	V
				MARTIN NIKOLLI			X	V	V	V	V
				MARTINE NIKOLLI			X	X	V	V	V
				GJOVALI NIKOLLI			X	X	V	V	V
				ALBERT NIKOLLI			X	X	V	V	V
				KUTIM NIKOLLI			X	X	V	V	V
	MRIKA DED MARGJELA	PRENG		GJINI NIKOLLI			V	V	V	V	V
				PRENGE ZEF NIKOLLI					V	V	V
				GJELE ZEF LLESHA			V				HEQJE DORE
				MARIE ZEF GJINI			V			DEDE	KOL
				DIORE ZEF PISTA			V				RRUSHINI
				NUSHA ZEF SCANA			V				NDUE DEDE
				NDUE ZEF NIKOLLI			V				RRUSHINI
				NDREK ZEF NIKOLLI			V	V			RRUSHINI
				LEKE ZEF NIKOLLI			V	V			RRUSHINI
				NIKOLIN ZEF NIKOLLI			V				RRUSHINI
				ASTRIT ZEF NIKOLLI			V				RRUSHINI
2104	SYBHI	VRIONI		HEKUR SYBHI					V	V	V
				ARBEN ARBON			V	V	V	V	V
				HEKUR SYBHI			V	V	V	V	V
				BLEDAR HEKURA			V	V	V	V	V
				ETLEVA HEKURA			V	V	V	V	V
				ENKELEJDA HEKURA			V	V	V	V	V
	DONIKA AGIM	SYBHI		OMARI SYBHI			V	V	V	V	V
				BONIN AGIM			X	X	V	V	V
				JORIDA AGIM			X	X	V	V	V
15386	NIKOLLI	VOKRRI		BIB VOKRRI					V	V	V
				MARE VOKRRI					V	V	V
				NDUE VOKRRI					V	V	V
				FRROK DAVE			NDUE	VOKRRI	V	V	V
				GJON ZEF			BIB VOKRRI	VOKRRI	V	V	V
6987	HAMID	COPANI		MUJARR EM					V	V	V
				PETRIT HAMID					V	V	V
				LITIF HAMID					V	V	V
				LULBETA HAMID					V	V	V
				BAIRAM HAMID					X	X	
				BASHKI M					V	V	V
				FLAMUR HAMID					V	V	V
17596	BILBI	OGRENI		HYSEN SKENDE RIE					V	V	V
				NAJME BAFAME					X	X	
				HYSEN OGRENI					X	X	
2065	OSMAN	XHAFA		DEMO					X	X	V
				TIFIK SABRI					X	X	V
				DEMO XHAFA					V	V	X
1837	HYSEN	HALLI		BAIRAM HAVA					V	V	V
				TAF HYSAN					V	V	V

SHENIM: Jë dokumentacioni është i rregullt shenohet me V, kur mungon shenohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shenohet me P.

NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFITIM	NUMER PERSONAL LLOGARINË BANCARE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILIAR	DESIMI TRASHIGTIME	PROKURE
2178	KOL	DEDAR USHINI		DAKE KOL					V	V	V
				RRUSHINI					V	V	V
				NORA LINE					X	X	
				RRUSHINI					X	X	
				GEZIM					X	X	
				NIKOLIN					X	X	
				ARIAN					X	X	
				PIPERIN					X	X	
				KOZETA					X	X	
				NDUE DEDE					V	V	P
				PRENDE BORE					V	V	P
				MARTE					V	V	P
				KOLE DEDE					V	V	P
				TOME					V	V	V
				PRELE LIN					V	V	P
				GJOK					V	V	P
13715	DODE	KOKA		MARK FRROK					V	V	V
				DODE KOKA					V	V	V
				GJOVALI NIKOLIN					X	X	
				AGOSTIN NIKOLIN					X	X	
				ZEF					X	X	
				DILA FRROK					X	X	
				GJG FRROK					X	X	
				DOD FRROK					X	X	
				DILA					V	V	V
				VIKTOR FRAN					V	V	V
				AGJ GJOK					X	X	V
1978	SHAKO	KAMBER AJ		ALUSH RIZA					V	V	V
				REFIT RIZA					V	V	V
				REFIE RIZA					V	V	P
				VIOLETA RIZA					V	V	P
				RAMIZ					V	V	
				HAMIR COBAN					V	V	V
				RRUFË RAMIZ					V	V	P
18619	KOZMA	DAULLE		THEMI VANGJEL KRISTINA FANUE					V	V	V
				KOZMA					X	X	
				KOZMA					X	X	
				NAKA					X	X	
				PRIFTI					X	X	
1312	SALI	PEPA		MELEQE DALIP					V	V	V
				HYSAN HYSAN					V	V	X
				PETRIT DALIP					V	V	V

TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E DYTË

Table with columns: ISHITDI, JARI POLITIK, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESEA, MBIEMER, EMER, ATESEA, MBIEMER, DOKUMENTAT, NUMER PERSONAL LOGARIM BANKARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGHIL FAMILIAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE.

Table with columns: ISHITDI, JARI POLITIK, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESEA, MBIEMER, EMER, ATESEA, MBIEMER, DOKUMENTAT, NUMER PERSONAL LOGARIM BANKARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE TRINGHIL FAMILIAR, DESHIMI TRASHIGIMIE, PROKURE.

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 1 Nëntor 2017 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Berisha nuk ka "shpëtim", fansat e ndjekin edhe në avion
- Ditëlindja, të rinjtë socialistë surprizojnë Saimir Tahirin
- Ervin Bushati: Mua s'mi lexon as gruaja mesazhet politike
- Qeveria në 'luftë' me tabelat, aksion për pastrimin e rrugëve

Modelja shqiptare me famë botërore pa të brendshme për Halloween




FJOLLA me poza të nxehta, tregon gjoksin



Rike Roçi:

Flet ish-banorja e "BB6": Ju tregoj ofertën që refuzova për të qenë pjesë e ekranit



Në Shqipëri ka ligësi dhe prapaskena, ja pse s'kthehem

Prëfjehet bukyroshtja blonde: Pse nuk postoj foto me të dashurin

Intervista

Flet ish-banorja e "BB6": Ju tregoj ofertën që refuzova për të qenë pjesë e ekranit

Rike Roçi:

Në Shqipëri ka ligësi dhe prapaskena, ja pse nuk kthehem

Rrëfehet bukuroshja bionde: Pse nuk postoj foto me të dashurin



Pamela Aliaj

Ajo njihet si një nga bukuroshet, e cila u bë e famshme nëpërmjet shtëpisë më të madhe në Shqipëri, "Big Brother Albania". Prej kohësh bukuroshja Rike Roçi i është larguar vëmendjes së medias rozë duke mos dashur të flasë shumë për jetën e saj private. Në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Rike flet për projektet e saj për të ardhmen dhe arsyen pse vendosi të largohet përfundimisht nga Shqipëria. Gjithashtu, ajo ka folur edhe për një projekt surprizë që pritet të dalë së shpejti në mediat sociale. Për më tepër në intervistën e mëposhtme:

Keni postuar shumë foto "hot". A do të postoni të tjera edhe më provokuese?

Fotot e mia nuk janë provokuese. Nuk është qëllimi im. Unë bëj fotot ashtu siç jam, shumë natyrale.

A do të guxonit të vinit foto nudo?

Nuk do bëja kurrë foto nudo. Nuk e kam dhe aq mentalitetin e hapur.

Keni pasur shumë komente lidhur me postimet që bëni në rrjetet sociale, çfarë reagimi keni lidhur me to?

Në rrjetet sociale kam komente pozitive dhe negative. Normal, i pranoj.

Është përfolur shpesh për jetën tuaj private pas disa fotosh të postuara në rrjetet sociale, ku ishit



në krah të një djali me të cilin keni kohë që jeni në një lidhje. A keni plane për martesë?

Në rrjetet sociale s'ka asnjë foto me të dashurin. E ruaj privatësinë time. Flasin për të ardhmen tonë shpesh, po për martesë akoma jo.

Keni ndonjë projekt për nëntorin? Ndonjë mundësi rikthimi në ekran?

Kisha një ofertë për t'u rikthyer në Shqipëri. Për një emision, por nuk gjetëm akordin e duhur, kështu që s'u bë gjë. Në Shqipëri s'i marr më fare në llogari pasi atje definitivisht mendoj që ka shumë prapaskena.

Fakti që ju shohim gjithnjë në formë e ka një sekret. Cili është sekretet i bukurisë tuaj?

S'kam sekret. Ndonjëherë bëj dietë maksimumi një javë. Pastaj rikthehem të ha çdo gjë. D.m.th. nëna natyrë ka qenë e mirë me mua edhe pse s'jam dhe kaq perfekte.

Kemi vënë re që postoni shpesh foto profesionale. A keni menduar të vazhdoni modelingun? A është ky një pasion i juaj?

Unë nuk jam modele pasi s'jam as e dobët e as e gjatë. Kam punuar që në moshë të vogël si fotomodele. Fotografia është një nga pasionet e mia. Edhe pse për momentin e kam lënë pas dore.

Cilat janë aspiratat e Rikes në të ardhmen? Ku e shihni më mirë veten?

E shoh veten një mama me shumë fëmijë.

Keni thënë para disa kohësh që në Itali keni një sallon bukurie që drejtoni. A keni plane të riktheheni të jetoni në Shqipëri, ndosh-

ta dhe me ndonjë biznes tuajin këtu apo është Italia shtëpia juaj për të ardhmen?

Po në Itali kam një sallon bukurie kur kohën më të madhe merrem me të. Në Shqipëri, jo kurrë nuk i duroj dot më njerëzit atje. Jam rritur në Itali dhe shtëpia ime është këtu. Edhe pse Shqipërinë e kam në zemër, por, siç thashë pak më parë, nuk përshattem me njerëzit. Ka shumë negativitet atje dhe ligësi. Nuk i duroj dot.

Bukuroshi që ju ka rrëmbyer zemrën për gjithë këto vite është shfaqur në një foto tuajën të postuar në plazh para disa muajsh. Keni ndonjë plan për fejesë apo

martesë?

Jam në një lidhje dhe kjo më mjafton për momentin.

Po për fëmijë a keni menduar? Për të krijuar një familje?

Këtë e mendoj në të ardhmen time, por jo tani.

Përveç biznesit, çfarë planesh keni tani së afërmi?

Bëj një jetë shumë të thjeshtë. Pjesën më të madhe e kaloj me familjen. Merrem me sallonin, bëj shumë kurse për t'i ndenjur pas tendencave të fundit të flokëve. Plus punoj me disa brande markash në Itali. Për momentin do t'i rikthehem edhe fotografisë, tani më si fotomodele.





Fjolla Morina është ndër këngëtares më të komentuar të muzikës shqiptare. Falë linjave të saj trupore, Fjolla njihet, gjithashtu, si një ndër këngëtares më seksi. Bukuroshja ka qenë shumë aktive në rrjetet sociale këto ditë. Së fundmi, në llogarinë e saj në "Instastory" ka publikuar disa foto ku duket shumë e kuruar dhe tepër joshëse e veshur me të brendshme të zeza. E gjithë vëmendja e atyre që shohin fotot bie te gjoksi i saj. Kujtojmë se "Vet ke met", është projekti i fundit nga Morina. Shumë shpejt Fjolla do sjelli një projekt të ri për fansat e saj.

FJOLLA me poza të nxehta, tregon gjoksin

SAMANTA sensuale nga dhoma e gjumit



Ajo është një nga këngëtares më të suksesshme në Shqipëri. Bëhet mjaft sensuale në llogarinë e saj në "Instagram". Ajo shfaqet me të brendshme të zeza dhe në një pozicion mjaft provokues duke ekspozuar gjoksin e saj. Por Samanta nuk është ndalur me kaq. Këngëtarja u është drejtuar të gjithë ndjekësve të saj e në veçanti fansave, duke postuar imazhin që vjen në formën e një dedikim për ta. "Për të gjithë ata që më duan,"-ka shkruar këngëtarja e njohur krahas fotos së publikuar.

MODELJA SHQIPTARE ME FAMË BOTËRORE PA TË BRENDSHME PËR HALLOWEEN



Modelja shqiptare me famë botërore ka ndezur rrjetin me veshjen e saj për Halloween. Tika Camaj ka zgjedhur të vishet si Kleopatra në këtë ditë feste. Fustani i saj mjaft provokues ka nxjerrë në pah format e saj trupore perfekte. Një fustan që të "detyron" të mos veshësh të brendshme. Këto fustane kaq provokuese janë tendenca e kohëve të fundit. Tika, modelja e njohur e Viktorias Secret njihet për pozat e saj shumë të komentuar. Modelja kohët e fundit ka ndryshuar pamje, duke u bërë një brune mjaft provokuese. Mos vallë ky ndryshim është bërë për shkak të personazhit që ajo ka kujtuar për Halloween? Tika gjithmonë ka qenë një nga biondet më tunduese dhe ndryshimi i fundit e bën të duket paksa e çuditshme.




BULEVARDI

POLITIK



Berisha nuk ka "shpëtim", fansat e ndjekin edhe në avion

Ish-kryeministri Berisha mbetet një nga politikanët më popullore në Shqipëri. Edhe pas kaq shumë vitesh në politike, ai vazhdon të pëlqehet pothuajse nga të gjithë. Kjo u pa edhe në udhëtimin e tij të ditëve të fundit, ku mori pjesë në Forumin e Krans Montanës. Ish-kryeministri ndodhej në avion duke udhëtuar dhe një radhë e madhe me njerëz prisnin për të shprehur një foto me të.



Ditëlindja, të rinjtë socialistë surprizojnë Saimir Tahirin

Ndonëse nuk po kalon ditë të qeta, për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, që feston sot 38-vjetorin, nuk kanë munguar surprizat. Në mbrëmje, një grup i FRESH-it ka zgjedhur që t'i bëjë një surprizë. Ata i kanë çuar një tortë me qirinjtë dhe kësaj surprize nuk i kanë munguar as fishekzjarrët. Padyshim që ky moment ka emocionuar ish-ministrin, i cili fryn i lumtur qirinjtë e tortës, së bashku me djalën e tij, teksa e mban në krahë.

Ervin Bushati: Mua s'mi lexon as gruaja mesazhet politike

Deputeti i Partisë Socialiste, Ervin Bushati nuk beson se ndryshimet politike vijnë nga mediat sociale, duke theksuar se pjesa e atyre që angazhohen politikisht në këto rrjete është e ulët. Ai tha me shaka që as bashkëshortja e tij nuk ia lexon statuset politike në "Facebook". "Vetëm një 6-7% mund të futet direkt në diskutime politike. Shumica e kanë të profilizuar. Shohin sajte sportive, me kafshë, me fotografi, me arredim shtëpish. Gratë kanë sajtet e tyre. Mua s'më lexon gruaja me lajmet politike dhe më thotë prit ta lexoj në darkë. Është e depolitizuar dhe shumë mirë bën. Po të kishim një parti jashtë tradicionales, për shembull zotëria në krah dhe unë, me gjithë karizmën sociale që mund të kishim në 'Facebook', nuk do të ishim bërë kurrë politikanë. Nuk mendoj se ai 30 e ca përqindësi kur di se ka aktor politik, që ka 1 mln ndjekës", u shpreh Bushati në "Tonight", Ilva Tare.



Qeveria në 'luftë' me tabelat, aksion për pastrimin e rrugëve

Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit vijuan aksionin për heqjen e tabelave të reklamave dhe ndërtimeve të vendosura përgjatë akseve kombëtare-rrugore. Në javën e katërt, aksioni është përqendruar në aksin Fier-Vlorë dhe Lezhë-Shkodër. Në total, në këto akse janë hequr 172 tabela dhe 14 ndërtime të lehta. Gjatë ndërhyrjes në më shumë se shtatë raste, autoritetet kanë bashkëpunuar me biznese të caktuara për të bërë zhvendosjen e materialit të tyre brenda kufirit rrethues të biznesit për të liru rrugën. Në bashkëpunim me komisarariatet respektive të policisë është bërë e mundur ndërhyrja në aksin Lezhë-Shkodër, ku janë hequr 88 tabela, ashtu sikurse është bërë edhe spostimi i gomave që ishin vendosur në anën e karrexhatës në dy subjekte tregtare.



BULEVARDI

POLITIK



Na merrni seriozis!..!



Sajti i ri hedh poshtë thashethemet nga trafikantët që keqinformojnë emigrantët

Voltiza Duro

Ministria e Jashtme Federale: Kush mund të qëndrojë në Gjermani

"Ja 4 format e mbrojtjes që duhen siguruar"

Tashmë të gjithë emigrantët apo të intere suarit që duan të jetojnë në shtetin gjerman mund të informohen për çdo paqartësi në faqen e re të internetit të Ministrisë së Jashtme Federale. Ky sajt informativ do të sigurojë fakte në mënyrë që emigrantët të mos keqinformohen. Faqja www.rumours-about-germany.info tregon se cilët individë kanë të drejtën e azilit apo të një forme tjetër mbrojtjeje në Gjermani. Gjithashtu, theksohet se të gjithë ata që nuk plotësojnë kriteret, duhet të kthehen sërish në vendin e tyre. Ky sajt synon hedhjen poshtë të thashethemeve të shpërndara në internet nga trafikantët dhe iu sugjeron të interesuarve alternativa të ndryshme për të punuar e jetuar legalisht në shtetin gjerman. Më poshtë jepen në mënyrë të detajuar format e mbrojtjes nga Gjermania për emigrantët.

MBROJTJA E REFUGJATËVE

Shpesh emigrantët mund të kenë dëgjuar se mund të shkojnë në Gjermani nëpërmjet azilit si refugjat ekonomik. Por, faqja zyrtare e Ministrisë së Jashtme Federale bën me dije se vështirësitë ekonomike nuk janë midis kriterëve që përcaktojnë refugjatët, pasi nuk ekziston një kategori e tillë ligjore. Autoritetet gjermane u japin refugjatëve një leje qëndrimi për tre vjet, pas së cilës ata përcaktojnë nëse duhet të jepet një shtyrje.

E DREJTA PËR AZIL

Azili është një formë tjetër e mbrojtjes sipas ligjit gjerman, që vlen veçanërisht për njerëzit që janë persekutuar për arsye politike. Për të pasur të drejtën e azilit, aplikantët duhet të sigurojnë dëshmi se shteti në vendin e tyre të origjinës i persekutojnë ata. Në praktikë, kjo formë e mbrojtjes është shumë e rrallë, por në qoftë se ajo është dhënë, ai siguron një leje qëndrimi për tre vjet, pas së cilës statusi i mbrojtjes merr rivlerësim.

MBROJTJA PLOTËSUESE

Azilkërkesit të cilët nuk kanë marrë mbrojtje nga refugjatët ose azil mund të marrin statusin e mbrojtjes plotësuere. Megjithatë, kjo jepet vetëm kur personi kërcënohet nga një dëm serioz në vendin e tij të origjinës, siç është dënimi me vdekje, tortura dhe dënimi çnjerëzor, ose nëse konflikti i armatosur ndërkombëtar ose i brendshëm kthen në vendin e origjinës kthimin e pa mundur. Statusi i mbrojtjes ndihmëse jep një leje qëndrimi vetëm për një vit, pas së cilës autoritetet gjermane përcaktojnë nëse duhet dhënë një shtyrje.



Faqja online e Ministrisë së Jashtme Federale

NDALIMI KOMBËTAR I KTHIMIT TË DETYRUAR

Forma e fundit e mbrojtjes zbatohet gjithashtu vetëm në rrethana të rralla dhe specifike. Autoritetet gjermane ndonjëherë i japin një ndalim kthimit të detyruar, që do të thotë se emigranti nuk mund të kthehet me forcë në shtëpi, edhe pse asnjë prej tre formave të tjera të mbrojtjes nuk zbatohen. Ky është ras-

ti kur autoritetet janë të bindura se një kthim në vendin e origjinës do të përbente një shkelje të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ose një rrezik konkret për jetën ose lirinë. Aplikanti merr një leje qëndrimi për një vit, pas së cilës rivendosja e ndalimit të kthimit të detyruar. Vetëm azilkërkesit që marrin një nga këto katër forma të

mbrojtjes kanë të drejtën të qëndrojnë në Gjermani. Ndërsa, të gjithë emigrantët e tjerë të parregullt që jetojnë në Gjermani në mënyrë të paligjshme, duhet të kthehen menjëherë në shtëpi vullnetarisht ose të ndiqen nga policia. Çdo vendim merret në një procedurë të detajuar nga Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët dhe çdo kërkesë vlerësohet në baza individuale.



Menaxhimi i ujit të pijshëm, nënshkruhet memorandum me Holandën

Memorandumi i nënshkruar mes ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë dhe Autoritetit Rajonal të Ujit të Delflandit në Holandë, synon bashkëpunimin në menaxhimin e ujit të pijshëm. Pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit, kryebashkiaku Veliaj theksoi se kjo marrëveshje shënon fillimin e një bashkëpunimi të gjatë për shkëmbimin e përvojave më të mira në fushën e shfrytëzimit të burimeve hidrike dhe për zhvillimin e qyteteve. Qëllimi i bashkëpunimit mes palëve është të përmirësojë eficientësinë dhe performancën e shërbimeve të ujit dhe të trajtimin e ujrave të ndotur në qytetin e Tiranës. "E vlerësoj shumë që po shoh diçka konkrete, sa i përket fillimit të bashkëpunimit tonë. Ky ishte viti i parë pozitiv për ujësjellësin, por misioni ynë është që gjithmonë të bëjmë më të mirën dhe besoj se edhe ky memorandum është një përpjekje për të bërë më mirë. Jo vetëm për të qenë ekipi më i mirë në Shqipëri, por të jemi konkurrues me çdo ujësjellës në Europë, që do të thotë që jo vetëm do të përmirësojmë infrastrukturën, por edhe buxhetin njerëzor", - tha Veliaj.

Manastirliu: Ofrohet konsultim për nënën e fëmijën

Kryeministri Rama: Do të rikonstruktojmë 300 qendra spitalore brenda 4 viteve

Kryeministri Edi Rama i shoqëruar nga ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu inspektoi rikonstruksionin e Qendrës Spitalore në Kamëz. Gjatë inspektimit, Rama tha se investimet të tilla do të vijojnë edhe në qendra të tjera spitalore në vend, duke ndikuar kështu në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe uljen e fluksit të pacientëve. "S'ka nevojë që të gjithë të turren në spitalin në qendër për të bërë edhe gjërat bazike që fare mirë mund të bëhen dhe këtu. Plani është për të rindërtuar 300 qendra në 4 vjet, duke filluar nga 2018-ta, kur duam të rindërtojmë me këto stan-



Kryeministri Edi Rama dhe Ogerta Manastirliu në Qendrën Spitalore në Kamëz

darde 80-90 të parat", -u shpreh Rama. Gjithashtu, kryeministri theksoi se do të punohet për të krijuar kushte optimale për urgjencën 24 orësh, si në këto qendra ashtu edhe në spitalet bashkiake. Ndërkaq, ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu në fjalën e saj tha se kjo qendër spitalore mundëson edhe konsultimin për nënën dhe fëmijën. "Kjo qendër shëndetësore i shërben 100 mijë banorëve të bashkisë Kamëz. Nga ana tjetër kemi shërbimin 24 orë të urgjencës, që është shumë i rëndësishëm për shërbimet e

emergjencës që banorët të mos shkojnë direkt në qendrën spitalore universitare apo në qendra të tjera, por të jenë këtu prapë, të kenë akses në 24 orë në 7 ditë të javës. Nga ana tjetër, janë të gjithë kabinetet e specialiteteve. Gjithashtu, kemi konsultoren e nënës dhe fëmijës, konsultimin për nënën, për vaksinimin e fëmijës, të gjithë kabinetet përkatëse me 10 mjekë specialistë", -tha Manastirliu. Ndërkohë, edhe stafi mjekësor që punon në Qendrën Spitalore në Kamëz, vlerësoi maksimalisht investimin e bërë për rikonstruksionin e kësaj qendre.

Kërcënohet kryebashkiaku i Belshit, agresori: Më jep 300 mijë euro ose të vrava



Kryetari i Bashkisë së Belshit, Arif Tafani

BELSH - Kryetari i Bashkisë së Belshit, Arif Tafani është kërcënuar me armë zjarri për shkak të detyrës. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ngjarja ndodhi mesditën e së hënës në aksin rrugor Belsh- Pajovë në vendin e quajtur "Fusha e bardhë". Mësohet se 31-vjeçari Rajan Qamil Tafani, banues në Belsh i ka zënë pritë kryebashkiakut në një kthesë dhe i ka vënë pistoletën në ije duke i

REAGIMI I BERISHËS

Ish-kryeministri Sali Berisha duke iu referuar denoncimit të një qytetari dixhital hedh hije dyshimi mbi denoncimin e bërë nga kryebashkiaku socialist i Belshit, Arif Tafani, i cili tha se është kërcënuar me jetë nga vëllai i ish-rivalit të tij për të marrë drejtimin e bashkisë. Sipas denoncimit të Berisha, personi që kryebashkiaku pretendon se e ka kërcënuar ka pasur një lokal me letra të rregullta dhe se kryebashkiaku ia ka prishur me qëllim që të ndërtojë aty një pallat për vete.

thënë: "Nuk ke më jetë po nuk më dhe 300.000 euro brenda një muaji. Më ke

prishur lokalin buzë liqenit dhe kjo do paguhet me kokën tënde. Që të shpëtosh

kokën do më paguash eurot dhe do më japësh një shesh ndërtimi të bashkia e re". Ndërkaq, vetë kreu i bashkisë i është përgjigjur agresorit: "Nuk të kam cenuar askund. Për çdo gjë kam zbatuar ligjin". Sipas burimeve të mësipërme, shtetasit Rajan Tafani (vëllai i ish-kandidatit të pavarur për kryetar bashkie në Belsh, Besjon Tafani), në vitin 2016

i është prishur lokali i familjes se tij nga ana e Bashkisë, pasi ishte përf-

shirë në objektet që do prisheshin në zbatim të planit urbanistik të qytetit. Menjëherë pas kallëzimit të bërë nga 49-vjeçari Arif Tafani, blutë kanë shoqëruar në Stacionin e Policisë Belsh 31-vjeçarin për sqarimin e mëtejshëm të rrethanave të ngjarjes. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprahe, materialet në ngarkim të Rajan Tafanit do t'i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprimet penale të "Kanosjes për shkak të detyrës".

Tentoi t'i vinte flakën autobotit, ndalohet protestuesi. Athina: Ndërpitni shembjet!

Prishja e objekteve në Himarë, banorët me flamuj grekë e amerikanë në protestë

HIMARË

Dhjetëra banorë të Himarës dje u hodhën në protestë për të mos lejuar prishjen e banesave të tyre që preken nga projekti për rivitalizimin urban të qendrës së qytetit. Me thirrjet: "Mos na i prekni shtëpitë", "Turp t'ju vijë" dhe me flamurin grek e atë amerikan në duar, pjesëmarrësit në tubim u përplasën me policinë gjatë aksionit të nisur nga IKMT. Gjithashtu, gjatë protestës janë dëgjuar dhe këngë greke, ndërsa banorët kanë akuzuar qeverinë. Ata deklaruan se Himara e vjetër u prish. Mes të tjerash, protestuesit pohuan që vëmendja duhet të shkojë tek ata që vadisin hashashin dhe jo tek ata. "Poshtë qeveria shqiptare. Është antipopullore. Është kundër Himarës. Duam Himarën e vjetër. Prishni shtëpitë e kryetarëve që janë bërë me soletë, pasi ne i kemi shekullore. Ku është qeveria shqiptare? Poshtë!", u shprehën banorët e Himarës. Ndërkaq, mësohet se gjatë aksionit të djeshëm janë shembur 8 objekte nga 24 gjithsej. Në këtë aksion, IKMT shoqërohej nga forca të shumta policore dhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSh). Policia ndaloi një prej banorëve protestues në Himarë, pasi tentoi që t'i vinte zjarrin një autoboti me gaz, me qëllim që të parandalohet shembja e banesave. Pas protestës në Himarë ka reaguar Athina. "Ne i bëjmë thirrje qeverisë shqiptare që të ndërpresë menjëherë çdo veprim kundër të drejtave të pjesëtarëve të pakicës etnike greke që jetojnë në Himarë," tha ministri i Jashtëm i Demokracisë së Re, George Koumoutsakos.

"BLINDIMI" I HIMARËS
Burime zyrtare nga policia dje pohuan se "Lidhur me zbatimin e vendimit për prishjen e disa objekteve në kuadër të Projektit "Rikualifikimi urban në Spille-Himarë", i cili është duke u zhvilluar, bëjmë me dije se: Në mbështetje të organeve ligjzbatuese (IKMT-së), të cilat marrin pjesë në shembjen e disa objekteve lidhur me Planin Rregullues në Himarë, për funksionimin dhe garantimin e ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike në këtë aksion janë në gatishmëri të plotë rreth 163 forca policore. Ndër këto forca, 10 janë grupe të FNSh-së si edhe shërbime të tjera policore prej DVP, Vlorë, prej Komisarariatit të Policisë Sarandë, Himarë dhe Delvinë". Gjithashtu, po të njëjtat burime deklaruan se "Në ambientet policore është shoqëruar një shtetas për arsye se ka tentuar të shkaktojë zjarrvënie në një autobus me gaz, i cili ndodhej në ambientin ku po shemben objektet. Policia e DVP Vlorë së bashku

me grupet e FNSh-së janë në gatishmëri për mbarëvajtjen sa më të qetë dhe pa probleme, për shmangien e çdo të papritur si edhe parandalimin e ndonjë akti të mundshëm kriminal deri në përfundim të aksionit".



Protesta e djeshme në Himarë



VANGJEL DULE
Kreu i PBDNJ, Vangjel Dule dje deklaroi nga Himara se kryeministri Edi Rama po shpërngul banorët himarjotë. Sipas tij, banorët e prekur nga prishjet e ndërtimeve nuk po dëmshpërblehen, ndërsa zgjidhje për ta mbetet vetëm shpërngulja. "Situata në Himarë është alarmante. Rama do shpërnguljen e banorëve të Himarës, por ata nuk do të dorëzohen lehtë. Banesat që po prishen i takojnë minoritetit etnik grek"- tha Dule.

re", i cili është duke u zhvilluar, bëjmë me dije se: Në mbështetje të organeve ligjzbatuese (IKMT-së), të cilat marrin pjesë në shembjen e disa objekteve lidhur me Planin Rregullues në Himarë, për funksionimin dhe garantimin e ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike në këtë aksion janë në gatishmëri të plotë rreth 163 forca policore. Ndër këto forca, 10 janë grupe të FNSh-së si edhe shërbime të tjera policore prej DVP, Vlorë, prej Komisarariatit të Policisë Sarandë, Himarë dhe Delvinë". Gjithashtu, po të njëjtat burime deklaruan se "Në ambientet policore është shoqëruar një shtetas për arsye se ka tentuar të shkaktojë zjarrvënie në një autobus me gaz, i cili ndodhej në ambientin ku po shemben objektet. Policia e DVP Vlorë së bashku



Vrau avokatin grek në mes të Athinës, bie në pranga 32-vjeçari shqiptar

GREQI - Pas rinisjes së hetimeve për vrasjen e avokatit grek i ekzekutuar në mes të Athinës më 12 tetor, autoritetet greke kanë vënë në pranga një 32-vjeçar shqiptar, i cili dyshohet se është autori i vrasjes së avokatit Mixalis Zafeiropoulos. Sipas mediave greke, policia bastisi në shtëpinë e shqiptarit pasditën e së dielës në lagjen Kallitha, ku u gjetën armë zjarri. 32-vjeçari ishte përpjekur të arratiset në Itali e Shqipëri, por nuk ia doli dhe u arrestua në Patra. Policia greke është në kërkim të dy bashkëpunëtorëve të tjerë të shqiptarit, të cilët dyshohen se janë përfshirë në vrasjen e Mixalis Zafeiropoulos. Emri i shqiptarit të arrestuar nuk behet me dije, ndërsa mësohet se është emër i njohur për autoritetet Helene. Mixalis Zafeiropoulos u vra me armën e tij ligjore më 12 tetor. Nga hetimet e deritanishme dyshohet se autorët kanë dashur ta trembin avokatin dhe t'i përcillnin atij një mesazh, por debati ka degraduar duke e qëlluar atë për vdekje. Të hënën policia mori në pyetje edhe 3 shqiptarë të tjerë, të cilët vajinë dënimin në burgun e Koridhalos, si persona që mund të kenë dijeni për vrasësit e avokatit. Sipas mediave greke, (zougla.gr) shqiptarët e marrë në pyetje janë: Albert Bako, Olti Dulçe dhe një tjetër me emrin Klodian. Policia dyshon se ata mund të kenë pasur rolin e ndërmjetësve me porositisit dhe vrasëseve.

Prangoset dhe 19-vjeçari nga Kruja, 2 të tjerë në kërkim

Trafiku i drogës, SHÇBA arreston efektivin e patrullës së policisë, Fatmir Meço



Fatmir Meço

në kërkim dhe shtetasit: A.M., 24 vjeç dhe R.T., 19 vjeç, me akuzën e "Prodhim-

it dhe shitjes së narkotikëve". Arrestimi i punonjësit të policisë Meço u bë pas një hetimi disa mujor, zhvilluar me metoda speciale nga SHÇBA. Nga ky hetim rezultoi se efektivin e komisarariatit të Durrësit bashkëpunonte me Fitim Selacin dhe dy të rinjtë e shpallur në kërkim, për prodhimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Sipas bluve, Fatmir Meço duke shfrytëzuar pozicionin e tij u garantonte pjesëtarëve të grupit lehtësi në mbajtjen dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Në disa raste, dyshohet se ky punonjës policie ka transportuar dhe shpërndarë edhe vetë lëndë narkotike. Gjatë kontrollit në banesë, 33-vjeçarit iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale një sasi lëndë narkotike e llojit kanabis, si dhe një presë për paketimin e lëndës narkotike. Ndërsa, në banesën e Fitim Selacit në Fushë-Krujë u sekuestrua një sasi prej 6.3 kg kanabis sativa. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme. **kl.ha.**

DURRËS - Një efektiv i policisë së Durrësit dje është arrestuar nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), në bashkëpunim me Sektorin Kundër Narkotikëve në policinë e këtij qyteti, pasi akuzohet për përfshirje në trafikun e drogës dhe shpërdorim detyre. Bëhet fjalë për 33-vjeçarin Fatmir Meço, punonjësi i patrullës së komisarariatit e policisë së Durrësit. Gjithashtu, ka rënë në pranga dhe 19-vjeçari Fitim Selaci, banues në Fushë-Krujë. Ndërkohë që janë shpallur

BOTIMI



Një trini ku përmbliidhen një sprovë e thukët, një përshkrim udhëtimi dhe brilante nga krijimtaria e Jevtushenkos

Visar Zhiti, libër për të birin: Sa ish burrëruar dhe zgjatur..

Sapo është botuar libri më i fundit i Visar Zhiti, "Si na erdhi ai, i ndaluar!". Libri është një rrëfim ngulmues me befasi, ku lidhen si me një fongo të errët dy kohë e dy breza me dëshmi poezinë dhe dhembjen.

Shkas dhe protagonistë janë poeti rus, Evgeni Jevtushenko bashkë me një student shqiptar me emrin Atjoni, biri i autorit. Njëpër një kësaj trinie përmbliidhen këtu një sprovë e thukët, shoqëruar me brilante nga krijimtaria e Jevtushenkos si dhe një përshkrim udhëtimi në vendin e tij me frymëzime nga andej, të përziera si rrallëherë në një libër.

Ky takim dritëdhënës, që vazhdojnë dhe në të përtejmen përbën një përshkrim për të kuptuar më mirë veten si një e vërtetë dramatikisht e bukur.

Nga Visar Zhiti

...buzëqesha edhe unë. Vëzhgim befasues, edhe i gjetur, edhe i guximshëm, edhe i bukur, edhe... S'kishte si të mos më dukej kështu, edhe ngaqë ma kishte thënë im bir, Atjoni, edhe ngaqë hapte debate e mundësi ballafaqimesh, madje midis brezash. Kishim dalë në ballkonin e vogël të apartamentit tonë në Tiranë dhe më pushtoi një si ndjesi sikur ndodheshim pezull midis tokës dhe qiellit, më afër baltës, të krijuar prej shirave më të fundit, teksa përsipër hapësira ngushtohesh padurueshëm prej pallateve përreth, fërgëllonte e copëzuar në ngjyrë ere, sikur kërkonte të shmangte retë, t'i bënte të paqena. Thitha sérish cigaren dhe përmes tymit po shikoja nga Atjoni. Sa është burrëruar dhe zgjatur, thashë me vete, ka mendime, edhe pse me mua flet pak, por ato që ka nisur të shkruajë, të bindin. Ajo pakëz mjekër, push ziosh në faqe, i ishte rritur dhe dendësuar disi, eh, student filozofie, viti II, i takon ta mbajë. Fitoi vetë një bursë në Universitetin Katolik "Sacro Cuore" në Milano. Kishte shumë butësi në fytyrë, tejet të shndritshme, por dhe siguri të mirë, gati të rreptë. I shihej në sytë e mëdhenj, në ballin e lartë, si buzëz e plota, por sidomos te nollat. Shpatullat i qenë zmadhuar, krahët, qafa e gjatë, e mermertë si e së ëmës. Kaçurrelat i qenë përhapur edhe më, nga ana e majtë i binin mbi sy. Më pëlqente më shumë kështu, sesa kur qetëhej fare, por dhe atëherë i zbulohesh koka e rregullt dhe kishte tjetër hijeshi. Kisha ëndje të futja gishtërinjtë nëpër flokët e tij, siç bëja kur ishte më i vogël, por e dëja që nuk do të më linte. Si i thoshin shokët në Milano, në klubin ku shkante në breg të lumit të Navillas, *cappelli importanti*, "flokë-rëndësishtmi"? Si Samsoni bibliki. Ndërkaq, mua s'më tregonte ndonjë gjë për Dalilën e Rahilut moderne të shkollës, për Zhuljetat, Liviat e Olimpiat etj... mamit po, dhe Eda m'i thoshte edhe mua. Jo të gjitha.



Në foto: Visar Zhiti

Kur ndodhte të bënim ndonjë copë rrugë bashkë, shkante andej nga "Biloku" të studioje në një librari të re, kisha parë vajzat që kthenin kokën nga ne. Me mua e kanë? - tallsha unë. Po, po, aty mbahu, - ma kthente me bezdi të gëzueshme.

Kishte ardhur me pushime. Dhe unë e pyeta për takimin, kisha kërshëri të dija në i kishte pëlqyer ai takim, duhej të kishte qenë i veçantë dhe ndryshe sipas meje. Me pak fjalë, ai më tha shumë më tepër nga ç'prisja, dhe jo atë që kisha paramenduar. M'u duk dhe si një lloj goditjeje.

Dhe u habita. Më vuri në mendime. Pyetjes sime sapa i ishte përgjigjur prapë me pyetje. ... *mos janë ca si egocentrikë ata që i ka përkëdhelur regjimi?* - Dhe pritni një grimëherë... Para kësaj më kishte thënë: ...*ishte interesant, por dhe narcist...* - Do të doja të ma shpjegonte. Por ai ma kishte kërkuar mua ndërkaq.

Përcaktoret *interesant* dhe *narcist*, pastaj togfjalëshi *egocentrikë e përkëdhelur...* m'u dukën si një zbulim i tij, se edhe unë e kisha takuar atë e nuk di të kem pasur

ftillime të tilla, kaq të qarta e përmbledhëse.

Po, po e kisha takuar edhe unë shumë vjet para Atjonit, le që e kisha takuar edhe më përpara se ta takoja. Në rrethana që dramatikisht zoheshin rëndësinë. Prandaj edhe takimi im real me të m'u duk si i përhënuar, ndodhi në dy ditë të huaja, të begata, që si kohë i ngjanin kthimit të mugëtirës në agshol, të paktën kështu ishte për mua. Takimin e tretë e bëri Atjoni si vazhdim të tyre, por më të njëmendtën, besoj. Në fakt, në takimin e tij ai ishte pa mua, por me mamën e tij. Ndoshta të gjitha këto copëra takimesh përbëjnë një të vetëm, kështu do të më pëlqente ta quaja, në copëra kohësh të ndryshme, të pangjashme, të përjetuara nga mosha të ndryshme. Siç thashë, unë e kisha takuar atë edhe kur nuk e kisha takuar, atëherë kur ishte rrezik, kështu më dukej dhe kur e takova, sikur nuk e kisha takuar, kishte qenë më i fortë mostakimi. Takimi i Atjonit ishte përmblyllës.

Do të desha të dija se ç' mund të kishte shtuar im bir, si mbresë, si perceptim, se nuk ishte një takim i zakonshëm, sipas meje. Vërtet do

"Si na erdhi ai, i ndaluar!", kujtime nga Atjoni dhe pjesë nga dosja e burgut

Në foto: Koptina e librit



Po shfletoja tani vonë dokumente, të nxjerra nga Autoriteti i Dosjeve, institucionin i krijatur rish-tazi, që, sipas kërkesës, të jep materiale nga arkivat sekrete të sh-tetit, të Ministrisë së Punëve të

Brendshme, të burgjeve, të dënimeve etj. Pra, isha denoncuar qysh student, nga ndonjë shok mes nesh. "Flaka"? I kujt mund të ishte denoncimi? Pseudonimi i gjithkujt? Jo, jo, më vinte keq dhe turp ta pranoja. Ishte i askujt. Doja ta ruaja imazhin e shokëve, të atij sinqeriteti e gëzimesh të varfra të asaj moshe... sa të tim biri tani, sa shokë të mirë e të sinqertë që janë ata... nuk doja ta pranoja spin-unin në dhomën time, le të mbetej jashtë, as në auditor as në bisedat në ndonjë bar në muzg, teksa me naivitet do të kem treguar: shiko ç'kam përkthyer... si shkruhet andej dhe si sh-

të ketë qenë mbresëlënëse, rrezël-litës, rast fatlum për një student, por me sa ndikim tek ai!

Çfarë gjeniu! - ishte e pritshme të thuhej në një rast kështoj, kurse im bir e kishte thyer këtë pritsh-mëri duke e parë ndryshe. Në fare pak kohë. Që as mund të quhej kohë. Dhe për kë kështu? Për një personalitet botëror, me famë. Po më pëlqente skajshëm gracka ku po bija.

Dhe m'u rikthye pyetja e tij, Përgjigjen po e ndieja jo vetëm si detyrë, por dhe si mundësi për ndonjë krijim. Si një shkak, sepse po e tregoj qysh në fillim, Atjoni më kishte thënë, ashtu shkujdes-ur, që *pse nuk bën një libër me...* dhe kjo për mua u shndërrua në porosi... sublime.

DENONCIME TË FSHEHTA...

"...*Bashkëpunëtori "Flaka" në datën 25.2.1974 informon se Visar Zhiti, student i vitit të tretë gjuhë-letërsi, merret me përkthime të poezive të poetëve hermetikë nga rusishtja si të Jevtushenkos, të poezive me theksa pesimistë të shkri-mtarit francez Pol Eluar, të poetit spanjoll Federiko Garcia Lor-ka, të poetit turk Nazim Hikmet*"...

U trondita kur e lexova, megjithëse kishin kaluar vite, ish-të ndërruar shekulli dhe kishte ardhur një mijëvjeçar tjetër e per-andoria komuniste kishte kohë që kishte rënë.

kruajmë ne... E ai, çfarë më tha? Ku shkoj më pas? Natën. Dërgoj letër apo takoi operativin? Ku? Pas mureve të Institutit apo në rrethinë? Takimi pranë WC-ve të... Të ketë raportuar me dashje apo e sh-trënguan? Iu djersit balli? Iu tur-bullua vështrimi? E zuri gjumi më pas? Si do të ketë dalë në provime? Po me mua a do të jetë takuar përsëri?

Si fillim i shkresës nxinte një tjetër denoncim, po kundër meje, "i depozituar" nga "Pena e artë". E i kujt do të qe ky pseudonim ve-zullues, i ndonjë shkri-mtari? Po tani ku është, deputet apo ka ikur fare? Pikë e zezë!... Po unë kam marrë dhe një çmim tani me këtë emër... A ta kthej si dekoratën e presidentit?... Pastaj më poshtë vinte "Flaka" për Jevtushenkon...

Dhe poshtë e më poshtë, sikur zbritje shkallëve të ferrit, një den-oncim i tretë: *Bashkëpunëtori "Rozafati" me datën 25.2.1974 informon: ... "është fjala për disa shfaqje hermetizimi në shkri-metë e disa stu-dentëve, që u lënë shkas interpreti-ve jo me paritshmi. Kështu ka ndodhur me studentin Visar Zhiti, i cili shkroi një poezi me këtë frymë dhe kjo u afishua te stenda e rrethit letrar të institutit, më vonë u hoq, por çfarë u bë me të, u diskutua apo jo nuk e dimë"*.

Mbaronte faqja e parë. Ky duhej të ishte denoncim pedagogu, me pseudonim legjendar. O Zot, cilët na paskan mësuar ne, ata që na kanë vrarë!...

Opinion i Ditës

Për Tahirin dhe jo vetëm...

Nga Kreshnik ÇIKA, Athinë

(Vijon nga faqja e parë)

... me zor funksionon, duke u përpjekur të duket shtet, e prandaj janë hedhur në sulm kundër Shqipërisë, qysh nga presidenti i Greqisë, e deri te ministri i Jashtëm i këtij vendi, i cili ka ftuar për takim disa ditore në Kretë Bushatin. Madje, meqë është disa ditësh takimi, do t'i krjohet mundësia edhe kryeministrit grek, të shkojë e ta pijë një kafe me ta në Kretë, nën aromën e këndshme të hashashit cilësor që prodhon ai ishull. Sepse për hir të së vërtetës, hashashi më cilësor në Ballkan, prodhohet në dy vende: në Lazarat dhe në Kretë. Më 28 tetor, presidenti i këtij vendi, në parakalimin e ushtrisë greke në Selanik, foli në radio me pilotin që fluturonte me "F16" mbi kokat e njerëzve, duke i kërcitur dhembët fqinjëve të vendit të tij: "Zoti pilot, krahët tuaj, krahët e Forcave Ajrore greke, i dërgojnë mesazh të qartë të gjithë fqinjëve tanë, mesazhin e spartanëve të vjetër: - "Μολών Λαβέ" (Eja merre, po ta mbajti!). Nuk mbeti pas as kryeministri Çipra, i cili ("do t'i zgjidhë" të gjitha problemet me ne në Kretë), kur deklaroi: "Përulmi para heronjve të epopesë, që ranë në malet e Shqipërisë, para atyre që mes Greqisë dhe jetës së tyre, zgjodhën të parën" (gazeta Kathimerini, 28.10.2017)... Pavlopulua, e di mirë sentencën: - "Sa më e gjerë të jetë gryka e topit, aq më e fortë është diplomacia". E për hir të së vërtetës, nuk e ka shumë keq.

Kurse Ministria e Jashtme e këtij vendi, deklaroi se... "shqetësohemi për zhvillimet në Spanjë dhe shpresojmë të rikthehet dialogu demokratik, sa më shpejt" (Vërtet, pse shqetësohen kaq shumë për Spanjën???)

Athina, në të gjitha deklaratat e saj, ka si busull prononcimit e nëpunësit numër 2 që ka të akredituar në Tiranë (se i treti vjen ambasadori i tyre aty), pra të "grekut" me emrin Dule. Dulja i Athinës aty "e ka gjetur" diagnozën e sëmundjes greko-shqiptare, kur deklaroi nga Bularat, nën flamurin grek: "Jemi të qetë për marrëdhëniet që kemi ngritur mes dy popujve. Nëse ka një problem midis vendit tonë dhe Greqisë, fatkeqësisht ai është vetëm kryeministri i vendit Edi Rama".

Vlen të nënvizohet se kryeministri Edi Rama, është i vetmi në këto 25 vite, që ka mbajtur qëndrim reciprok me Athinë. Regjimi i vakët i Ministrisë së Tiranës "për Europën dhe punët e Jashtme", ndërhyrjen në punët e brendshme nga shteti grek, ishte një veprim, sa "me u gjend Kola n'punë". Athina me thirrjen e Dules, doli në mbrojtje të shtatë familjeve xace të Himarës, për të themeluar nga hiçi, minoritetin grek, në zemrën e Labërisë, në Himarë. Por... "Shteti shqiptar, i rrëzoi shtëpitë e "komunitetit himariot" prite kur të na dalin edhe racë më vete këta banorë... për të tërhequr vëmendjen nga skandalit që i plasoi me ish-ministrin e Brendshëm" deklaroi Athina...

Cështjen "Tahirin" për hir të së vërtetës, e rrezoj në Komisionin e Mandateve, qysh në 10 minutat e para të mbledhjes, juristi i mirënjohur Ulsi Manja. Thjesht, me pyetjen: -Prej sa kohësh, Saimir Tahiri, është subjekt i hetimit?

Por, duhet të bëhet rituali i plotë, e në vend të dy muajve, që zgjati ai komision për Bashën para ca vitesh, të paktën duhet të zgjaste dy ditë në këtë rast.

Prokurori, me një shqipe të belbër e duke folur ngadalë (aty çdo gjë lëviz ngadalë, edhe autobusët "urbanë" ecin me 3-4 km në orë, me një krye linjën "Tirana e re" e cila pronarin e ka bash në bashin e Bashkisë së Tiranës së vjetër, edhe trenat ecin ngadalë - (vërtet, a ka më të tillë në Shqipëri)? - gjithçka ecën ngadalë)... Kurse mensheviu Alibeaj me ngazëllim e hienën në gjakun e presë së vet, "i jep zemër" kolegut Tahiri: "Po ti shko në burg, e përlëshu me drejtësinë, si një bolshe-



vik i vërtetë"! Pra, me gjuhën e belbër, e me ton të ulët prej babaxhani, prokurori shpalosi "akuzën" ndaj tij, d.m.th. ato pak fjalë që kishin arritur t'i përkthenin për 48 orë nga gazeta italiane, përgjimet e prokurorisë italiane, të bëra për 48 muaj rresht, për bandën italo-shqiptare të Habilajve.. Sepse kështu janë bandat: greko-shqiptare, italo-shqiptare etj. Janë doemos kështu, pasi ky kapitalizmi ka në bazë ligjin kërkese-ofertë. E meqë kërkesa është italiane, greke, holandeze, e gjithfarë, kuptohet që banda italo-shqiptare e Habilajve tanë, banda greko-shqiptare e Balilajve tanë, e të gjitha të ngjashmit e tyre, janë ofertuesit. Në njëfarë mënyre, "natyrshëm" në shoqërinë e konsumit, në shqiptarët, ofrojmë shërbimin, madje me mall shumë cilësor, por edhe me çmime të arsyeshme. Këto i pohojnë grekët këtu në Athinë, në kafenet e lagjeve...

Për Tahirin, do të vendosë drejtësia, ajo drejtësia e Tiranës, ashtu siç është katandisur, për të cilën 50% të "meritës" e ka partia e Tahirin, e pjesën tjetër doemos e ka "pala tjetër". Ajo që duhet të shqetësojë botën shqiptare, kryesisht mediat, por edhe "opinjonistët" gjithlogë, mendoj se duhet të jetë diçka tjetër...

KATANDISJA E UNIFORMËS BLU DHE...

Hashashi në Shqipëri i ka fillimet e tij, qysh kur erdhi fara për herë të parë, në vitin jo aq të largët 1994. E u mboll e u shijua, njëlloj, si në Lazarat, ashtu dhe në Dukagjin, por më në fund edhe në Labëri e në Skrapar: U mboll e hodhi shtat, para syve të mbarë politikës shqiptare, të të gjithë policëve dhe ushtarakëve shqiptarë, të gjithë prokurorëve, shikasve dhe gjykatësve të atij vendi. Aty kanë qenë të gjithë, madje janë paguar edhe me rrogë shteti, përveç të tjerave që kanë marrë... E mbollën dhe e rritën me dashuri, të gjithë shqiptarët, si vëllezër; "demokratë" dhe "socialistë", në të gjithë fshatrat, pa dallim feje, krahine dhe ideje.

Ministri "i ri" i Rendit në Tiranë, vendosi ta luftojë kultivimin dhe shitjen e hashashit, duke mbajtur në krye të policisë, pikërisht ata të cilët ishin dhe janë përgjegjësit kryesorë; drejtorin e Përgjithshëm, por edhe nëndrejtorin, atë që përgjigjet për rendin-preferencë dhe emërtësë e partisë së dytë në qeverisje, deri më 23 qershor! Dhe nuk i përtoi dora, që përsëri "në emër të duarve të pastra", të largonte nga ajo drejtori, një apo dy drejtues që kishin bërë thjesht me pastërti dhe profesio-

alizëm, punën e shtetit! Punë e tij, dhe e atyre që i besuan atë funksion... Ashtu siç në emër të "duarve të pastra", u shkri zinxhiri drejtues i policisë së Elbasanit, pa pyetur nëse ish-shefi i krimeve të atij qarku, është njëri ndër pak oficerët e pastër të policisë së shtetit...

Duhet të ketë ndjekur njeriu, prononcimin e dy njerëzve: deputetit Pjerin Ndreu-ish drejtues i lartë i policisë shqiptare, por edhe prononcimin e një "burgaxhiu" - sot në kërkim, oficer të antidrogës Andon Nazëraj prej 2006 e deri në 17 korrik të vitit 2014, kur edhe u arrestua. Thjesht, të shijojë "veprën" e politikës shqiptare në këto 25 vite mbi njerëzit me uniformë, në të gjithë "madhësitë" e vet.

Oficerë policie që dalin në postbloqe me plan të miratuar, hartuar nga drejtorja e qarkut. E që kërcënohen nga njerëz të botës së nëndheshme, në emër të lidhjeve që ata kanë, apo që supozohet se kanë, me eprorët madhorë të policëve. Nazëraj, kuptohet, nuk ka qenë engjell, edhe ai "e ka marrë kafën e vet". Po përse të mos ta merrte fundja, kur ata të "kontrollit" të brendshëm, ia kërkonin euro apo dollarë, nja pesë mijë "të holla"?

Por meqenëse Nazëraj figuron i dënuar me vendim gjykatë e në kërkim, le t'i besojmë ish-drejtesit të lartë të policisë, deputetit Pjerin Ndreu. Zoti Ndreu, para kamerës, i tha të vërtetat aqçik e jashtë dhembëve, sa i takon katandisjes së policisë. Ai tha me një fjali të vetme, se përgjegjësi kryesor dhe i vetëm që shkatërroi policinë ndër vite, ishin partitë politike, të dyja ato të mëdhatë. Me emërime nepotike, me njerëz të paaftë (zakonisht këta janë më të përshtatshmit "për të drejtuar" aty), shpesh me personalitet të sakatur. Sepse aty në Shqipëri, politika ecën me parimin: - "Ai që di të bindet, di edhe të komandojë". Mirëpo është ky "parimi", që ka sjellë gjendjen katastrofike në polici dhe në ushtri...

... E UNIFORMËS KAKI!

Shkruesi i këtyre radhëve, me edukim e formim bazë dhe me profesion, është ushtarak, tanimë nënkolonel në rezervë. I cili nuk mundi të jetojë aty me pensionin që i jepet, e që hallet familjare e detyruan të marrë rrugët e botës. Për pasojë, është njohës i mirë i "veprës" që realizoi politika në këto vite, mbi (jo në) Forcat e Armatosura. Me dhimbje të madhe, më duhet të pohoj, se sa herë vij në vendim tim e takoj miq e shokë, kolegë, një pjesë e vogël e të cilëve janë ende nën uniformë, brengosem.

Jo vetëm nga pamjet qesharake të "paradave" që bëhen këto vite në sheshin "Skënderbej". Por meqë shkolla "Skënderbej" u mbyll para 24 vitesh, shkon tek ish-Shkolla e Lartë e Oficerëve (gjithashtu, e mbyllur edhe kjo), që sot e katër vite quhet dhe Ministria e Mbrojtjes. Shkon te porta të ftoch shokun e mikun për një kafe, dhe merr përgjigjen ogurzeze: - "Nuk na lenë të dalim jashtë, se na shënojnë emrin, e emri shkon lart". Dhe e dëgjon këtë fjali nga ushtarakë madhorë, kolonelë dhe generalë, aktivë, por edhe në rezervë, të cilët ende vazhdojnë të jenë në detyra të ndryshme. Kjo më ndodhi para katër muajsh, herën e fundit që isha në Tiranë. Vetëm kur pashë ushtarë të policisë ushtarake te postbloku, madje më thanë se janë edhe disa me rrobe civile që ruajnë, se mos ndonjë kolonel apo general del jashtë për kafe, e t'i shkruajnë emrin në një bllok që enkas e mbajnë aty, mbi një copë llamarinë!!! Të gjithë, të thonë me pezëm se janë të detyruar ta pinë kafën vetëm në mensën e ish-Shkollës së Bashkuar-pranë supës nikolimiane, siç shprehen ata. U mbyllën para tre vitesh, tre llokalet kafe, që ishin në territorin e shkollës. U lanë kështu gjastë familje pa punë, në emër të "shitjes së pijeve", që nuk ekzistonin. Kurse tani, shkojnë dhe e pinë rakinë pranë supës nikolimiane, me faturë të "rregullit", 70 lekë taken... E kështu, ushtarakët e të gjitha ranqeve, janë katandisur thjesht në kundërfirmues të letrave, e kryesisht në përpilues shkresash, për të cilat marrin urdhra gojorë, përmes telefonit, nga... "lart". Ata që kanë guxuar të kenë mendim tjetër; thjesht kanë lënë vendin e punës, apo në rastin më të mirë, janë degdisur në... Repartin! Askund në botë, përveçse aty, nuk ndodh, që nëpunës të rëndomtë shteti, që ju i quani edhe "udhëheqje civile", civilër (e jo civilë), të cilët hera dhe interesat e dyshimit i sjellin në ato funksione, të shkojnë pa mesnatës në repart ushtarak, e të japin alarm për kompletin repart!!! Thjesht, sepse komandanti i sapo emëruar në detyrë, kishte harruar të dërgonte "kafen" në zyrën e emërtesës... Dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, thjesht siglon Urdhër-shkarkimin e komandantit, ashtu siç sigloi para ca kohe urdhrin për emërimin e tij, pa e pyetur askush...

Ishte para dy vitesh një gjeneral major, që i tha ministrin në zyrë: - Mos më bërtit mua, se unë kam kohë që e kam vuarë frikën! Doli në rezervë gjenerali që kishte vuarë frikën, e shteti nuk pati më nevojë për të, edhe pse ishte "Doktor i Shkencave", në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Por jo doktor me plagjiaturë, të lutem. Ndoshta për këtë arsye, edhe nuk u hyn në punë.

Më të drejtë, lexuesi mund të pyesë: Po mirë, këta "ushtarakët tanë", nuk paskan asnjë lloj përgjegjësie në këtë katandisje? Këtë pyetje e ka zgjidhur Shekspiri para 600 vitesh, kur tha: "Po të mos ishin qengja këta, nuk do të ishin uqër ata". Dhe ende ka të drejtë Shekspiri. Sepse nuk doli një, po një ushtarak, të thoshte në 25 vite: - Nuk e firmos urdhrin tuaj zotëri, pasi vjen në kundërshtim me ligjin! Kështu që ushtarakët janë katandisur individë sociale, kur të thonë: - "Kam fëmijë për të rritur dhe shkolluar. Kur u mjafton atyre, mua më tepron". Nuk doli një ushtarak, i cili të mos firmoste uniformat-zheqe që mbajnë, të cilat shteti (lexo: ministrat e radhës), i marrin me tender nga... Gabi i Elbasanit! Për uniformat e ushtarakëve, kompania e mirënjohur botërisht "Marck Group", dërgoi një gjeneral me dy yje aty në Tiranë. Por shqiptat ia thanë troc: - Nuk do të fitoni ju! Ata ikën me vrap, për të mos njollsur emrin e firmës, në vitin 2012, e ku? - Në Shqipëri! E pritja e mallit, kushton "vetëm" 25 milionë euro, nga taksat e shqiptarëve barkatë! E ushtarakët, firmosën me sy mbyllur, duke mos pyetur për specifikimet teknike të mallit, të cilat vetë ata i kishin hartuar. Pra, porositin terital, e marrin... mushama nga ajo e Rruga-Urës dikur!... Fshati që duket, nuk do kallauz-thotë popullit. Edhe me siglat e ushtarakëve, "gjeneralëve", u rrafshuan 12 godina luksoze të "Rrapi i Treshit", nga të cilat tri ishin të rikonstruktura në vitin 2009, e tri godina ishin ndërtaur me miliona euro në vitin 2012. Sepse i duhet dikujt ajo tokë, për të bërë... "stadium"!! Dhe mbasi i rrafshuan me urdhrë partie, u thonë gjeneralëve në vitin 2017: - Shkonit e i nxirrni jashtë përdorimit!!! Ata, si "guma të mirë", firmosën pa shkuar fare atje, pasi i kishin parë me sytë e tyre, fadromat që rrafshuan godinat, e larguan së andejmi

Opinioni i Ditës

Nga Miron Çako*

Lojërat e fatit, një "fat" i keq!

... Por, lojërat e fatit si lojërat elektronike, kazinotë, llotot, bastet etj., që janë përhapur si kërpudhat mbas shiut...

detyrime financiare për veten ose familjen. Ai pushon së qeni social në familje, shoqëri edhe mendon e preokupohet vetëm për bixhozin.

mesatarisht rreth 50% e atyre që preken nga problemi e lojëratë të fatit kryejnë krimet për të mbështetur varsinë e tyre.

da me psikologun, konsulta me neurologun për gjendjet e vartësisë dhe stresin e pamenaxhueshëm me simptomat që përmendëm më sipër.

Pavarësisht të gjithave këto, "profilaksia" nuk mjaftojnë për t'u çliruar nga patologjia e lojëratë të fatit, sepse personit me këtë vartësi i duhet një fuqi më madhore për të përforcuar personalitetin e dobësuar dhe për t'u liruar nga vesi.

Mbreti i urtë Solomoni, (shek. IX PRK), thotë për pasurinë e humbur në kumar: "Është një lëngatë shumë e keqe që e pash nën diell: pasuria e ruajtur për të keqen e të zotit. Me ndërmarje të gabuar pasuria e tij mbaron".

Paraja mund të kthehet në një "zot" për njeriun, duke kontrolluar gjithë energjitë shpirtërore, fizike dhe kohën, madje të konkurojë me Zotin e vërtetë. Krishti e quan paranë e fituar padrejtësisht si "mama" (demon i parasë).

Apostulli Pavli (shek IPSK) thotë: "Sepse lakmia për para është rrënia e gjithë të këqijave dhe duke e lakmuar atë fort, disa u larguan nga besimi dhe e depërtuan veten e tyre në shumë dhimbje".

Përvoja shekullore e njerëzve që duan të dalin nga kurthi i lakmisë, duke qenë të varur nga lojërat e fatit, kumari, llotot, bastet etj. tregon se rruga më e mirë dhe e sigurt është të besosh të Zotit i Gjithëpushtetshëm, të pendohesh dhe t'i kërkohësh ndihmë për t'u çliruar nga kjo vartësi patologjike sepse: "Ajo që është e pamundur për njerëzit, është e mundur për Perëndinë".

Në fund edhe një këshillë për pronarët e lojëratë të fatit që kërkojnë të vënë pasuri me këto lojëra fati për veten e tyre, por që bëhen një "fat" i keq për shumë viktimë, si individë, familje dhe shoqëri: "Mos u mbështetmi në pasuri të padrejtë, sepse asgjë s'do të ndihmojë ditën e mjerrimit. (gjykimit të Zotit)".

*Përgjegjës i Zyrës Katakizmit KOASH



jetën, tentojnë të shkëputen nga kjo vartësi, por e kanë të pamundur.

Njerëzit e prekur nga çrregullimi i stresit post-traumatik ose PTSD jetojnë me nivele të larta stresi dhe ankthi, 34% e atyre që kërkojnë trajtim për varsinë e kumarit, shfaqin simptoma të PTSD. Statistikat e varsinës nga kumari tregojnë një zhvillim të lartë të llojeve të caktuara të sëmundjeve mendore, disa prej të cilave përfshijnë: çrregullime depresionit, çrregullime ankthi, çrregullime të keqpërdorimit të substancave narkotike, çrregullimi antisocial i personalitetit.

shoqërore. E gjitha kjo tregon "fatin" e keq të lojëratë të fatit që premtojnë para qyl, por në të vërtet nuk janë gjë tjetër; veçse një kurth ku të çon lakmia për para, që Bibla e quan shkakanë e gjithë të këqijave. Por, si mund të dalësh nga kjo vartësi patologjike me shumë pasoja individuale dhe sociale?

Që një sëmundje të shërohet, nuk mjafton vetëm diagnostikimi, por duhet edhe profilaksia e duhur. E para është ndërgjegjësimi i riskut dhe rrezikut të lojëratë të fatit, bixhozit, bastit etj. Ashtu si njeriu e kupton rrezikun e një sëmundjeje infektive dhe largohet nga vendi dhe personat e infektuar, kështu duhet të bëjë çdoqush që të largohet nga vendet ku gjenden virusi "fat" ose më mirë lakmi për para.

E dyta, shoqëria civile duhet të ndikojë tek shteti, që me ligjet e nevojshme të bëjë sa më të mundur pakësimin e këtyre lojëratë të fatit dhe këto të jenë sa më larg qendrave urbane.

E treta, duhet kontrolli familjar, ndihma e shoqërisë, apo edhe bise-

Komandant Regimenti në Veri, kishim ekonomi ndihmëse. Vinte mishi i vjeshës së tretë, e mbarohet ushqimi, bar nuk kishte. Aq sa kishin ngelur; thërrisja zboristët të vinin e t'i therrnin, që të mos ngordhnin urie. Ata bënin një gardh në një kodrinë, ngrinin ca drurë atje për t'i varur kur i rripnin, e fillonin biçakun. E rrëmbente kasapi më kërrabë delen, e i priste kokën. Delja që ishte pranë saj vazhdonte të... "kulloste"! E çfarë hante ajo mbi akullin që kishte veshur kodrinën?! Thjeshtë, i mbushte mendjen vetes,

se kasapi vetëm me atë nuk do të kishte punë.... Këta jemi, e kështu jemi katandisur në ushtarakë shqiptarë... përfundoi duke psherëtitur koloneli D.J.H.

Dhe... "Djemtë e korbit, sa venë e nxihen" do të shkruante i madhi Nonda Bulka në vitin 1934.

Këto të shikojnë opinionistët gjithologë aty, e ndonjë ushtarak, nëse ende kanë mbetur të tillë...

Të gjithë ministrat e radhës, që hera dhe interesat e dyshimit i kanë dërguar atje, fjalia e parë që kanë thënë në intervistën e parë të tyre,

edhe laçin. Sepse... "kanë fëmijë, për të rritur dhe shkolluar"! A thua se fëmijët e shqiptarëve të tjerë, që nuk janë ushtarakë nën uniformë, e që nuk firmosin në asnjë bordero, mbetën pa u rritur dhe të pa shkollë! Në të gjithë botën, përveç në Shqipëri, ushtrinë e ekuajnë, e llogarisin dhe e respektojnë si burriera e kombit. Por në Shqipëri, ndodh e kundërta: E shikojnë punën e ushtarakut si një vend pune. Njëri ndër pak kolonellët dinjtiozë që kanë mbetur aty, para tre muajsh ishte në Athinë, të fëmijët e tij. "Kur isha

HOROSKOPI

DASHI

Ironia e juaj thërrisë, sot bëhet më e hidhur nga ndikimi negativ i Merkurit. Në vend që t'u përgjigjen ftesave të njeriut të zemërs, do të parapëlqeni të rini me miqtë. Më pas do të përpigjeni të fitoni kohën e humbur, por nuk do të jetë e thjeshtë.

DEMI

Shqetësimi nuk do të jetë i lehtë për t'u mbajtur nën kontroll. Do të bëjë që marrëdhëniet me të tjerët t'i kenin sipas kapriçive të humorit. Qetësohuni! Nuk duhet të pranoni propozimin e një të riqohuri, sepse më vonë do t'i ndihëni në borb.

BINJAKET

Sot vjet nuk janë shumë të shqëlqyeshme. Do të shqetësoheni për çështje profesionale, të cilat nuk do të jenë problematike. Në punë mos bëni shumë në sy, rini të qetë dhe shfaqini aftësitë e tuaja në momentin e duhur.

GAFORJA

Në familje do të kenë disa kundërshtime të shkaktuara nga këndvështrimet e ndryshme. Mos u mërzi,ni. Iarshmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për t'u ngritur. Falënderoni këtoqet që ju rini pranë duke ju dhënë ide dhe mundësi të mira.

LUANI

Jeni të hapur për bashkëpunime dhe të gatshëm të jepni ide të reja. Sa keq që Mërkuri angazhohet duke ju vënë shkopinj në rrota. Do të dini të vlerësoni plotësisht personin që ju rri përkatë dhe t'i kushtoni vëmendjen e duhur.

VIRGJERESHA

Me mbështetjen e Merkurit, por me armiqërinë e Marsit dhe Venusit, Hëna në diellin tuaj do të bëjë që të ndiheni fajtor në qasur. Është e kotë të prisni ndryshime në punë. Jeni ju që duhet të bëni diçka për t'u ngjitur në detyrë.

PESHORJA

Kujdes nga çështjet që kanë të bëjnë me financat, sepse mund të shkaktohen vonesa dhe pengesa në pagesa. Më mirë të merreni vesh më këto gjëra. Shqetësimi në fushën e dashurisë, për shkak të Venusit kundra, mund të bëjë që të merrni vendime gjaknxehta.

AKREPI

Do të kaloni pengesat dhe do t'ia dilni më në fund të vëni në zbatim një ide që e kemi tërënjshëm më këto gjëra. Shqetësimi në fushën e dashurisë, për shkak të Venusit kundra, mund të bëjë që të merrni vendime gjaknxehta.

SHIGJETARI

Jupiteri do të bashkëprojetojë me Diellin e Hënën, duke ju favorizuar së tepërmi. Sot do të jeni optimistë dhe do t'ia dilni të merrni çdo gjë që doni me angazhim minimal. Potenciali krijues është në nivelin më të lartë për këtë muaj.

BRICJAPI

Qëndroni afër një bashkëpunëtori që ka zakon të flasë pak si shumë. Ka rrezik që të përhapë fjalë jo shumë të mira për ju. Mund t'i kërkontë këshillën e kujt të doni, por mos lejoni të ndikoheni prej zgjedhje që kanë të bëjnë me fushën e dashurisë.

UJORI

Nëse jeni beqar, dikush do t'ju afrohet me ndjenja të sinqerta, po ngadhënjimi nuk do të jetë i lehtë. Do të pretendoni gjithmonë shumë. Në horizont shquhen mundësi të mira profesionale, që duhen shfrytëzuar menjëherë. Mos i lini t'ju ikin.

PESHQIT

Hëna do të ndikojë që ritmet e ditës do të bëhen të paqëndrueshme. Do të jetoni momente kënaqësie, por edhe castë pasigurie. Mos e shmangni afrimin e një personi që kenë njohur së fundmi, mund t'ju bëjë kureshtar më shumë seç mendoni.

Grupimi "Ultras Guerriils" ka bërë të qartë prej disa javësh se nuk do të mbështesë më futbollistët e Partizanit në stadiume, por vetëm fanellën e klubit. Por me sa duket, mbështetësit e Partizanit nuk do të ndalen këtu, pasi nëpërmjet rrjeteve sociale kanë zgjedhur t'i bëjnë thirrje presidentit Gazment Demi që të vhihet në lëvizje për të ndryshuar sa më parë situatën. Në mesazhin e radhës të postuar në "Facebook", ky grupim nuk ka ngurruar të sulmojë



drejtuesit dhe lojtarët, të cilët prej 5 vitesh nuk fitojnë asgjë në futbollin sh-

Ultrasit e kuq nuk pajtohen me situatën e krijuar në këtë sezon

"Guerrills" e kapin me Demin: Jepi drejtim situatës!

qiptar dhe shfaqin mungesë serioziteti, me fjalë të cilat nuk kanë shumë nevojë për interpretim. "Lojtarë! Iliputë dhe drejtues të paafetë prej 5 vitesh! Po ty president? A nuk të vjen pak inat? A nuk shqetësohesh ndopak? Apo nuk ka problem, ti fjalën tënde e ke

thënë për 70-vjetor. Vitet para i kemi, ke thënë. Fundja je brenda objektivit që ke caktuar! Por neve na dhemb shpirti kur shohim se pas humbjeve, lojtarët zgërdhohen sapo lënë stadiumin. Harbohen nëpër lokale dhe meqë nuk mbushin dot me pikë tabelën e renditjes,

mbushin me foto 'Facebook'-un dhe 'Instagram'-in. Trofetë e vetme të lojtarëve dhe drejtuesve janë shishet e boshatisura dhe skedinat-çarçaf! 'Kampionë' të vërtetë! Ky sezon u dogj që pa nisur dhe përgjegjësi kanë të gjithë, por askush nuk e merr përsipër, sepse

nuk kanë fytyrë të na dalin përballë kur shohin që ne prapë vijojmë ta mbështesim legjendën me gjithë shpirt! President, ndërhy, jepi drejtim, nuk mjafton t'u varësh çelësat në qafë drejtuesve që vetëm fshihen, nuk mjafton t'i llastosh lojtarët me paga marramendëse dhe pastaj të vazhdojnë në qejfin e tyre jashtë çdo objektivit, por edhe larg partizanëve që i kanë hije Partizanit", lexohet në postimin e grupimit të vetëm në mbështetje të Partizanit.

Në Lisbonë bardhezinjtë vuajnë, por i shpëton sulmuesi argjentinas, Gonzalo Higuain



Jeton Selimi

Kualifikohen ekipet e para Higuain shpëton Juventusin

PSG, Bajern, Junajtid e Barça kalojnë më tej

Një gol i Gonzalo Higuain ka shpëtuar Juventusin nga një humbje përballë Sporting të Lisbonës që do të kishte komplikuar ndeshëm kualifikimin e bardhezinjve në fazën tjetër të Ligës së Kampionëve. Skuadra italiane gjendej në disavantazh që nga minuta e 20 e sfidës pas golit të Cesar për vendasit dhe nuk po arrinte të gjente një të çarë për të mposhtur portugezët. U desh një lëvizje mjeshtërore e sulmuesit argjentinas pak minuta para fundit për t'u shmangur pozicionin jashtë loje dhe për të dërguar topin në rrjetë duke vulosur barazimin 1-1. PSG kualifikohet për në raundin e 1/16 të Champions League. Parizienët kanë shkatërruar 5-0 Andelehtin duke kryesuar me meritë të plotë grupin B. Neymar, Ver-rati dhe tripleta e Kurzavass vulosën triumfin e sotëm. Sakaq në ndeshjen tjetër Bajerni i Mynihut ka fituar 1-2 në fushën e Sëlltik duke prerë gjithashtu biletën e kualifikimit. Manchester Junajtid nuk gabon. Djajtë e kuq kanë fituar 2-0 përballë Benfikës duke siguruar kualifikimin për në raundin



tjetër të Champions League në grupin A. Ndërkaq, në ndeshjen tjetër, Bazeli i Taulant Xhakës ndërlikoi gjithçka pasi u mund në shtëpi 1-2 nga CSKA e Moskës. Tashmë të dyja këto ekipe kanë gjatë pikë dhe do rivalizojnë


në dy ndeshjet e mbetura. Ndryshon gjithçka në Grupin C të Ligës së Kampionëve. Ka mjaftuar një fitore e pastër e Romës ndaj Çelsit për të vënë në diskutim edhe një herë fatin e skuadrave në këtë grup, ku tani janë ital-

ianët ata që kryesojnë. Ekipi i drejtuar nga Di Françesko i ka dhënë një leksion futbollit anglezëve të Kontes duke filluar që nga minuta e parë, kur El Sharau kaloi në avantazh ekipin e tij me një goditje të rrfreshme. Ishte përsëri sulmuesi italian ai që shënoi në minutën e 36 duke dyfishuar shifrat, ndërsa Peroti, me goditjen e tij nga jashtë zonës në minutën e 63-të vulosi rezultatin 3-0 të kësaj fitoreje të rëndësishme. Në ndeshjen tjetër të grupit, Karabaku i Ansi Agollit ka arritur të ndalë përsëri Atletico Madrid në një barazim. Mishel i dha avantazhin skuadrës azere ku Agolli ish-

CHAMPIONS FAZA E GRUPEVE		
GRUPI A		
Bazel - CSKA Moskë	1-2	
Man.UTD - Benfika	2-0	
GRUPI B		
Sëlltik - Bajern Mynih	1-2	
PSG - Anderleht	5-0	
GRUPI C		
Atletiko Madrid-Karabag	1-1	
Roma - Çelsi	3-0	
GRUPI D		
Olimpiakos - Barcelona	0-0	
Sporting - Juventus	1-1	

te titullar edhe në këtë transfertë, ndërsa Tomas barazoi shifrat me një goditje perfekte në minutën e 56.

PLAY-OFF



Trajneri i Suedisë mban shënim Shqipërinë për të thyer Italinë

Trajneri i përfaqësueses suedeze të futbollit, Jane Anderson, duket se e parandehet që shorti i play-off të eliminatorëve të Botërorit "Rusi 2018" do ta vinte përballë Italisë. Në një intervistë për mediat italiane, ai ka deklaruar se Italia ishte ekipi i vetëm të cilin ka monitoruar para ndeshjeve të fundit në grup, ndonëse shorti mund t'u rezervonte suedezeve ekipet e tjera. "Kur pashe emrin e Italisë, isha i lumtur se mund të filloja punën që të njihja më mirë kundërshtarin. Ndaj kam filluar t'i studioj dhe të përgatitem. Kam punuar, në vend që të qëndroja në pritje, para se ta dinim se kush do të na dilte para në play-off nuk kishte kuptim që të studiojmë ekipet. Por Jonas Tern (ish-futbollist i cili në vitet '90 ka luajtur në Serinë A) ishte në stadium për të ndjekur Shqipëri-Itali, për të spiunuar pak", tregoi Anderson. Sipas tij, Suedia nuk do ta përballojë më frikë duelin e dyfishtë të nëntorit. "Italia është një kombëtare e madhe, me shumë traditë dhe histori. Sigurisht që do të përballlemi me një kundërshtar të madh dhe kam respekt për Italinë dhe për detyrën që na pret. E përsëris, respekt, por jo frikë. Nuk duhet të mëndojmë për historinë. Nuk ka rëndësi se sa herë ka fituar Italia kupën e botës. Ka rëndësi vetëm e tashmja, forma e sotme, lojtarët aktualë të tyre dhe tanët", deklaroi Anderson.

DELA VALE MUND TË SHESË KLUBIN

Seria A kthehet në modë, sheikët duan Fiorentinën

Kampionati italian i futbollit ka filluar të tërheqë përsëri vëmendjen e investitorëve të huaj. Nëse më parë miliarderët e lindjes kishin sytë vetëm nga Anglia, tani ata janë të gatshëm të hyjnë në futbollin italian për të marrë kontrollin e klubeve të rëndësishme. Italo-amerikani Xhejms Palota ka marrë në pronësi Romën, ndërsa kinezët kontrollojnë Milanin e Interin. Por një tjetër klub mund të bëhet shumë shpejt me pronarë të huaj, pasi është nxjerrë në shitje prej disa muajsh. Bëhet fjalë për Fiorentinën, të cilën familja Dela Vale është gati ta shesë për 250 milionë euro. Mediat italiane bëjnë të ditur se gjatë ditëve të fundit ka pasur interesim nga Rusia, Kina dhe Arabia Saudite për të blerë klubin. Por Diego Dela Vale kërkon një person shumë të besuar dhe për momentin ka refuzuar ofertat e tyre. Megjithatë, nëse tifozët e skuadrës do të vazhdojnë të kontestojnë presidentin ashtu siç kanë bërë gjatë vitit të fundit, për të të jetë e vështirë t'u rezistojë ofertave të tilla dhe parashikohet që brenda këtij sezoni, ekipi të kalojë në duart e investitorëve të huaj.



Nuk do luhet të hënën

Federata vijon avazin, ndryshon sërish kalendarin e fundjavës




diumit "Loro Boriçi" është mbjellë bari. FSHF-ja ka dhënë "OK"-in për zhvillimin e ndeshjes në fjalë në këtë fushë dhe ky është një lajm i mirë në Shkodër.

SUPERLIGA	
JAVA E 9	
TË SHUTUNËN	
Luftëtari-Lushnja	14:00
Kamza-Partizani	14:00
Teuta-Laçi	17:00
TË DIELËN	
Vllaznia-Skënderbeu	14:00
Flamurtari-Kukësi	17:00

Pesë ndeshjet e javës së 9-të të Superiores ishin programuar fillimisht të luheshin në tri ditë, nga e shtuna në të hënë, por Federata Shqiptare e Futbollit, si gjithmonë ka bërë ndryshime. Tri ndeshje luhet të shtunën dhe dy të dielën. Ndryshimi është se ndeshja Vllaznia-Skënderbeu, e programuar për të hënën, pasi korçarët luajnë të enjten në Europa League, është spostuar të dielën. Po ashtu, Luftëtari-Lushnja luhet të shtunën dhe jo të dielën. Kjo ndeshje do të luhet në fushën sportive "Reshit Rusi", pasi në fushën e sta-

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Hari spiune.
4. Janë toksike.
9. Gjysmë arrest.
10. Janë vende pa ne.
13. Johnny y Donnie Brasco.
15. Priten nga meridianë.
18. Me të nxjerrin një letër.
20. U verbua nga Askushi.
21. Një britmë në arenë.
22. Shkrimtari i J'accuse.
24. Si moral.
25. Nota e diapazonit.
26. Me dies në një liturgji.
27. Një mund të jetë edhe veprimi.
28. Eshhtë e re pas Krishtit.
29. Inicialet e Bergman aktore.
30. Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.
32. Fise pa fe.
33. Një provë zjarri.

34. Eshhtë mjeshtri me... baketë.
37. Digjen po nuk u zbuluan.
39. Igli te Lazio.
41. Kush del... mbështet.
42. Mund të jetë unik.
46. Ngrihen për atentate.
47. Janë fjetore në kazerma.
48. Altini mestushor.

VERTIKAL

1. Fillojnë matanë.
2. Një Hans artist dadaist.
3. Eshhtë mjet rrethoror lundrimi.
5. Eshhtë ënjtje.
6. Lumi i Elizit.
7. Fillojnë mpijjen.
8. Eshhtë e gjithë Hiëna.
10. Eshhtë qetësues për neurozat.

VERTIKAL

11. Taylor aktore.
12. Daniel i Robinson Crusoe.
14. Kështu janë skenat që mallëngjejnë.
16. Eshhtë pjesë në skenë.
17. Lëvizje Ekologjike Lokale.
19. Përshkohe nga Leti.
22. Eshhtë muzika më e... kollajtë.
23. Grazia Cucinotta aktore.
24. Veriu pa ekstreme.
27. Janë tre në tricikël.
30. Scola, regjisor italian.
31. Kufizojnë një metër.
34. Mbahet me inat.
35. Mbyllin kurse.
36. Ka një shpejtësi fantastike.
38. Laik kur s'është ai.
40. Një liqen i kripur.
43. Një mund të jetë fetar.
44. Eshhtë lloj papagalli.
45. Në hyrje të sallës.
46. Priten në skaje.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Janë lokale me kubete.
9. Me të nxjerrin në tapë.
11. Polanski regjisor.
12. Qeni i famshëm i Odiseut.
15. Mbeten në fund.
16. Gabon në ekstreme.
18. Rreh në kufij.
19. Eshhtë vepër për një... vepër.
23. Janë udhëtime për në një vend të shenjtë.
25. Dinë shumë gjuhë.
26. Një mendim.
27. Famëkeqi Capone.
28. Kush i kthen... të braktis.
29. Kisha pa zë.
30. I fejuari i kukullës Barbie.
32. Ritet pa re.
33. Një brinjë në skuadër.
35. Emri i Zola.
37. Eshhtë mosha e të miturit.

HORIZONTAL


40. Një dispozitiv kohe.
41. Janë strehë për barinj.
42. Fillojnë aksionin.
43. Eshhtë ai që nuk qesh.
45. Të parat në ambient.
46. Gjysmë teorie.
47. Një binar.
48. Djeg kur bie.

VERTIKAL

1. Barrymore aktore.
2. Tiriac që qe tenis.
3. Ekstreme në studim.
4. Eshhtë kleri me papën.
5. Ndezur në aparaturë.
6. Kaluar në krye.
7. Janë racë e pastër.
10. Duhet fituar me djersë.
13. Një dritë për sake.
14. Lëvizin pasi mendohen shumë.
16. Janë sfera për bingo.
17. Eshhtë më pak se nxehtësi.
19. Gibson aktor.
20. Tregtonin skilevër dikur.
21. Mund të jenë fetare të tilla.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një sherr në shtyp.
24. Një lidhëz.
25. Mund të jenë cigaresh.
29. Mund të bëjë zoom.
31. Ndërmarrje Industriale Mirditë.
33. Pak konkrete.
34. Eshhtë i mirë me shokë shumë.
36. Artikull për shumë francezë.
38. Kanto kur nuk... ka.
39. Muzika me jam session.
44. Mbyllin një sherr.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



SUDOKU

7				6	4			
2		3			9	5		
	1					7	3	9
8	6		7	4				5
9			8		2			1
	4			3	6		7	2
4	9	8						1
		5	4			2		6
			5	1				7

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	1	7	3	2	8	6	9	5
5	2	8	9	7	6	3	1	4
6	3	9	5	1	4	2	8	7
7	4	5	2	8	3	1	6	9
9	6	3	7	5	1	8	4	2
2	8	1	4	6	9	5	7	3
3	9	6	8	4	5	7	2	1
8	7	4	1	3	2	9	5	6
1	5	2	6	9	7	4	3	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Eshhtë më mirë t'i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni.

(Mark Tueni)

- Askush nuk është nderuar ndonjëherë për atë që ka marrë. Nderimi ka qenë për atë që ai ka dhënë.



(Kelvin Tuejxh)

- Kur keni filluar të mos jepni më kontribut, keni filluar të vdisni.

(Eleanor Rusvelt)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



Chënie të mençura

- Ka tre lloj njerëzish: ata që shohin, ata që shohin atë që u tregohet, dhe ata që nuk shohin.
- Buzëqesh gjithnjë, edhe pse buzëqeshja jote është e trishtuar, sepse më i trishtuar se një buzëqeshje është trishtimi që nuk buzëqesh kurrë....
- Pema me kokrra synohet, tjetra harrohet...
- Bota është plot dyer, plot raste, fije të tendosura që presin t'u biesh. (Ralf Valdo Emerson)
- Te jesh gjithmonë i ndershëm me veten, është një ushtrim i këndshëm.

(Sigmund Frojdi)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

